

RAPORTI VJETOR

2024



PËRMBAJTJA

1. Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm	5
2. Rreth shoqërisë SiCRED sh.a.	6
3. Pronësia dhe Organet Drejtuese të SiCRED sh.a.	7
4. Zhvillimet kryesore gjatë vitit 2024	10
5. Objektivat e shoqërisë SiCRED sh.a. për vitin 2025	19
6. Përmbledhëse e SiCRED Assistance për vitin e përmbyllur në 31.12.2024	20
7. Ecuria e shoqërisë SiCRED Distribution gjatë vitit 2024	21
8. Dalja nga struktura aksionare e shoqërisë “Credins Invest”	22
9. Raporti Vjetor i Njesisë së Auditit të Brendshëm 2024	22

TË DHËNAT PËR SICRED SH.A. (31 DHJETOR 2024)



1. FJALA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM



Të nderuar aksionarë, klientë dhe bashkëpunëtorë,

Kam kënaqësinë t'ju prezantoj Raportin Vjetor 2024 të shoqërisë SiCRED, një përmbledhje e përpjekjeve, zhvillimeve dhe arritjeve që kanë shënuar rrugëtimin tonë gjatë vitit të kaluar.

Gjatë vitit 2024, SiCRED shënoi rritje si në primet e shkruara, ashtu edhe në dëmet e paguara. Këta tregues përforcojnë angazhimin tonë për të qenë gjithnjë pranë klientëve tanë, duke ofruar mbështetje të qëndrueshme dhe duke përmbushur me korrektësi përgjegjësitë që burojnë nga misioni ynë. Besueshmëria e produkteve tona dhe përkushtimi për t'u përshtatur me nevojat reale të individëve dhe familjeve, si dhe bizneseve dhe punonjësve të tyre mbeten themeli i punës sonë.

Një ndër shtyllat e zhvillimit tonë gjatë viti që lamë pas ka qenë përmirësimi i infrastrukturës teknologjike të sistemit të dedikuar të sigurimeve. Investimet në këtë drejtim kanë mundësuar një administrim më efikas, më të shpejtë dhe të sigurt të proceseve të sigurimit.

Pohoj me bindje se përpjekjet për të ofruar produkte gjithëpërfshirëse dhe një shërbim model do të vijojnë të jenë në fokusin tonë për vitin 2025, për t'i qëndruar besnikë misionit tonë, në një treg dinamik dhe shpesh herë të paqëndrueshëm.

Në mbyllje të këtij mesazhi të shkurtës, shpreh mirënjohjen time të veçantë ndaj stafit të SiCRED për profesionalizmin dhe përkushtimin e treguar ndër vite, ndaj aksionarëve për mbështetjen e vazhdueshme, dhe ndaj klientëve për besimin e çmuar që na japin çdo ditë.

Për më tepër, ju ftoj të shfletoni Raportin Vjetor 2024 për të mësuar më shumë mbi rezultatet tona dhe synimet për të ardhmen.

Singerisht,

Genc Koxhaj
Drejtori i Përgjithshëm

2. RRETH SHOQËRISË SiCRED SH.A.

Shoqëria SiCRED sh.a. është themeluar në 7 Tetor 2003, duke qenë kështu e para dhe e vetmja shoqëri sigurimi private në Shqipëri me kapital 100% vendas e licencuar për të vepruar në fushën e sigurimit të Jetës. Shoqëria operon në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe kuadrin rregullator, në bazë të Autorizimit për të vepruar si shoqëri sigurimesh Nr.8 datë 19.07.2004 (zëvendësuar me Licencën Nr.8/2004, datë 22.06.2012), si dhe të Lejes për Ushtrimin e Veprimtarisë në Sigurime, Nr.8/1 datë 10.09.2004.

Me qëllim diversifikimin e aktivitetit dhe ofrimin e një game më të gjerë përfitimesh për klientin, shoqëria SiCRED sh.a. ka investuar në kuota aksionare në shoqëritë:

- **SiCRED ASSISTANCE sh.p.k.**, e cila ofron shërbime në përputhje me legjislacionin në fuqi, për Sigurinë dhe Shëndetin në punë; Ndërmjetësimin në Punësim dhe Ndërmjetësimin në Shërbime Shëndetësore. SiCRED sh.a. zotëron 100% të kapitalit të kësaj shoqërie.
- **SiCRED Distribution sh.p.k.**, e cila është e fokusuar në biznesin e artizanatit, veshjeve dhe produkteve tradicionale shqiptare Made in Albania. SiCRED sh.a. zotëron 100% të kapitalit të kësaj shoqërie.

4.1 Vizioni ynë

Klienti është fokusi ynë. Vizioni ynë për të ardhmen është që të bëhemi mbështetja kryesore dhe zgjedhja e padiskutueshme e klientit.

4.2 Misioni ynë

Ne synojmë që të operojmë konform standardeve më të larta të etikës, si mënyra e vetme dhe e pranueshme për të bërë një emër të mirë, e forcuar kjo nga premtimi ynë për të përcjellë besueshmëri, duke mbajtur gjithnjë parasysh atë që është më e mirë për klientët tanë. Përmes produkteve tona, synojmë që të krijojmë një kulturë të re sigurimesh në mjedisin shqiptar. Klientët dhe partnerët tanë të biznesit duhet të ndihen plotësisht të kënaqur me zgjedhjen e tyre dhe besimin që kanë treguar duke përzgjedhur shoqërinë SiCRED sh.a. për sigurimin e tyre.

3. PRONËSIA DHE ORGANET DREJTUESE

Organet e larta drejtuese të shoqërisë përbëhen nga:¹

- A. Asambleja e Aksionarëve
- B. Këshilli Mbikëqyrës
- C. Drejtoria e Përgjithshme

A. Asambleja Aksionare e shoqërisë SiCRED sh.a., e renditur sipas kuotës së aksioneve, përbëhet nga:

	Kuota Aksionare
1. Z. Aleksandër PILO	46.39 %
2. Z. Renis TËRSHANA	30.16 %
3. Z. Maltin KORKUTI	4.75 %
4. Znj. Monika MILO	4.75 %
5. Z. Kristino KROMIDHA	4.05 %
6. Z. Egi SANTO	2.37 %
7. Znj. Emi SANTO	2.37 %
8. Z. Arben TAIP	2.06 %
9. Z. Petraq SHOMO	2.06 %
10. Z. Artan XHORI	1.03 %

B. Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë SiCRED sh.a.:

- | | |
|--------------------|---------|
| 1. Z. Artan XHORI | Kryetar |
| 2. Z. Selman LAMAJ | Anëtar |
| 3. Z. Egi Santo | Anëtar |


C. Drejtoria e Përgjithshme:

- | | |
|-------------------|------------------------|
| 1. Z. Genc KOXHAJ | Drejtor i Përgjithshëm |
|-------------------|------------------------|

Komitetet dhe organizma të tjera të Shoqërisë SiCRED:

1. **Komiteti i Auditimit/Njësia e Auditimit të Brendshëm** funksionon në mënyrë të pavarur dhe objektive, duke ushtruar kontrolle në sistemin e brendshëm të shoqërisë, për të siguruar përputhshmërinë e aktivitetit të shoqërisë në pajtueshmëri me kuadrin rregullator dhe aktet e brendshme të shoqërisë SiCRED sh.a. si dhe për të dhënë opinion të specializuar në funksion të përmirësimit të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit.
2. **Komiteti i Administrimit të Rrezikut** ka si funksion identifikimin e risqeve dhe mbajtjen e tyre nën kontroll, ku në mënyrë periodike kryhet edhe monitorimi përkatës dhe raportimi i çdo incidenti apo luhatjeje.
3. **Këshilli i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë** sigurohet që ambientet e punës të jenë të sigurt dhe komode si dhe sigurohet që të zbatohen dispozitat e ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe aktet nënligjore të tij.
4. **Njësia e Parandalimit të Pastrimit të Parave** sigurohet që të zbatohen dispozitat e ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, nëpërmjet sistemeve efektive që kontrollojnë përputhjen me praktikën më të mira dhe rekomandimet e AMF-së dhe organizatave të tjera.

ORGANIGRAMA E SiCRED SH.A.



Organigrama e mësipërme është miratuar me Vendimin nr. 1, datë 09.02.2024, të Këshillit Mbikëqyrës të SiCRED sh.a..

BORDI I DREJTORËVE



GENC KOXHAJ

Drejtör i
Përgjithshëm



MATILDA THOMA

Audit i Brendshëm



GLADIOLA JANI

Drejto-re-Drejto-ria e
Marrjes në Sigurim
dhe Korporatave



ONKITA KODRA

Drejto-re-Drejto-ria e
Shitjeve dhe Dega
Tiranë



PETRINA DUKA

Drejto-re-Drejto-ria e
Administrimit dhe
Aktuaristikës



TEUTA LOCAJ

Drejto-re-Drejto-ria
e Financës dhe
Kontabilitetit



VJOSA BODO MUJO

Drejto-re-Drejto-ria
Juridike dhe e
Burimeve Njerëzore



ERIK ÇELO

Shëf i Sektorit të
Administrimit të
Rrjetit të Degëve
dhe Teknologjisë së
Informacionit



ERJON LAMA

Shëf i Sektorit të
Burimeve Njerëzore



GRETA SEJDINAJ

Shëfe e Sektorit
Marketing dhe
Projekte

4. ZHVILLIMET KRYESORE GJATË VITIT 2024

4.1 Ecuria e tregut të sigurimeve në vitin 2024

Gjatë vitit 2024, tregu i sigurimeve ka vijuar me një ecuri pozitive, duke shënuar rritje si në segmentin e sigurimeve të jetës, ashtu edhe në atë të sigurimeve jo-jetë. Primet e shkruara bruto kanë shënuar një rritje prej 7.03% në nivel tregu, duke reflektuar një zgjerim të qëndrueshëm të aktivitetit të sigurimit.

Në të njëjtën kohë, dëmet e paguara bruto kanë pësuar një rritje të konsiderueshme, me një ndryshim vjetor prej 24.38%. Pjesën më të madhe të kësaj rritjeje e përbën tregu i sigurimeve jo-jetë, me një rritje prej 24.88%. Në total, gjatë vitit janë paguar 73,482 dëme.

Më poshtë paraqitet tabela që përmbledh ecurinë e tregut të sigurimeve për vitet 2023–2024, së bashku me ndryshimin përkatës në përqindje.

Primet e shkruara bruto të sigurimit 2023-2024*

Veprimtaria	Primet e shkruara bruto (në mijë lekë)		Ndryshimi në %
	2023	2024	
Jeta	1,859,195	2,070,422	11.36
Jo-Jeta	21,023,727	22,424,827	6.66
Risigurimi	14,071	10,530	(25.16)
Total	22,896,993	24,505,779	7.03

*Burimi: Buletini Statistikor, Tregu i Sigurimeve, AMF, Viti 2024

Dëmet e paguara bruto 2023-2024*


Veprimtaria	Dëmet e paguara bruto (në mijë lekë)		Ndryshimi në %
	2023	2024	
Aktiviteti i Jetës	282,490	334,167	18.29
Aktiviteti i Jo-Jetës	6,294,455	7,860,217	24.88
Dëme të Paguara Fond Kompensimi	382,514	461,667	20.69
Total	6,959,459	8,656,050	24.38

*Burimi: Buletini Statistikor, Tregu i Sigurimeve, AMF, Viti 2024


4.2 Lista e produkteve të shoqërisë SiCRED sh.a. në fund të vitit 2024

1. **Sigurimi i Jetës për Hua**, i cili ofron mbulim në rast të humbjes së jetës së personit të siguruar (kredimarrësit) për shkaqe natyrore apo aksidentale. Ky sigurim është një garanci financiare si për institucionin kredidhënës ashtu edhe për kredimarrësin (personi i siguruar), duke çliruar familjen e personit kredimarrës nga pagesa e kredisë së mbetur.
2. **Sigurimi i Jetës dhe Shëndetit (CASH PLAN)**, i cili, përveç sigurimit të jetës, ofron një gamë të gjerë përfitimesh, si mbulim të shpenzimeve mjekësore në rast sëmundjeje apo aksidenti etj., tërësisht të personalizuar sipas kërkesave për sigurim të klientit.
3. **Sigurimi i Jetës (me Mbijetesë)**, i cili përbën një skemë afatgjatë sigurimi dhe kursimi. Personi paguan çdo vit primin e sigurimit, një pjesë e të cilit investohet dhe një pjesë shkon për sigurimin e jetës. Polica ka të përcaktuar një shumë sigurimi të cilin personi e përfiton në fund të kontratës së sigurimit, ose e përfitojnë trashëgimtarët e tij nëse i siguruari ndërron jetë gjatë periudhës së sigurimit.
4. **Sigurimi i Jetës Evolutive**, i cili siguron jetën e një individi të interesuar për të mbrojtur financiarisht të ardhmen e familjarëve, të cilët varen ekonomikisht prej tij.
5. **Sigurimi i Jetës nga Sëmundjet e Papritura dhe Aksidentet**, i cili është dizenuar për të ofruar mbrojtje financiare për pasardhësit e të sigurvearit, nëse ky i fundit humbet jetën në mënyrë të papritur nga një sëmundje apo aksident.
6. **Sigurimi i Jetës dhe Aksidenteve në Grup**, i cili ofron mbrojtje financiare për të sigurvearin në rast të ndodhjes së aksidenteve: për mbulim të shpenzime mjekësore, paaftësisë së përhershme apo të përkohshme, etj.
7. **Sigurimi i Jetës së Nxënësve dhe Studentëve**, i cili ofron një garanci në rast të çdo të papriture shëndetësore apo aksidentale të nxënësit/studentit, mbulimin e rrezikut të shfaqjes së sëmundjeve kritike, rrezikun e humbjes së jetës së personit, etj.
8. **Sigurimi i Jetës dhe Shëndetit në Udhëtim**, i cili ofron mbulim për një sërë rreziqesh që mund të ndodhin gjatë periudhës së udhëtimit, për të sigurvearit që udhëtojnë jashtë Shqipërisë.
9. **Sigurimi i Jetës dhe Shëndetit të Studentëve**, i cili përbën një garanci financiare për shëndetin e studentëve që zgjedhin të studiojnë jashtë Shqipërisë. Ofron mbulim të shpenzimeve për probleme shëndetësore si pasoje e sëmundjeve apo aksidenteve, shpenzime për evakuim urgjent, riatdhesim, etj.
10. **Sigurimi i Jetës me Kursim**, i cili ofron një mbështetje financiare për personin e siguruar, i cili përfiton për mbijetesë në maturim të kontratës, si dhe për pasardhësit e tij në rast të humbjes së jetës së personit të siguruar.
11. **Sigurimi i Kombinuar i Jetës**, është një produkt i përshtatshëm për skema profesionale, i cili ofron mbulim për çdo ngjarje të papritur, për shkaqe natyrore apo aksidentale si dhe shfaqjen e sëmundjeve kritike, etj.
12. **Sigurimi i Jetës së Depozitarit**, një produkt i cili u adresohet depozituesve në njërin nga bankat e nivelit të dytë. Ofrohet në partneritet me institucionin bankar.
13. **Sigurimi i Jetës dhe Shëndetit të Vizitorit**, i cili ofrohet për personat e huaj që vizitojnë Shqipërinë, apo që qëndrojnë në Shqipëri për periudha deri në një vit.
14. **Sigurimi i Jetës dhe Shëndetit të Sportistëve**, i cili ofron mbulim të shpenzimeve mjekësore në rast aksidenti, mbulon rrezikun e vdekjes së të sigurvearit (sportistit) për shkaqe natyrore apo aksidentale, rrezikun e dëmtimeve fizike (trupore) si pasoje e aksidentit, etj.

4.3 Ndarja e Primit të Shkruar Bruto sipas produkteve kryesore të shoqërisë SiCRED sh.a. gjatë viteve 2023 - 2024



4.4 Treguesit financiarë² kryesorë të SiCRED sh.a. në periudhën 2020-2024



² Sipas Pasqyrave Financiare të Veçuara të Shoqërisë SiCRED sh.a.

³ Sipas Pasqyrave Financiare të Konsoliduara të Shoqërisë SiCRED sh.a..

4.5 Bashkëpunimi me Credins Invest

Ka vijuar bashkëpunimi disavjeçar midis SiCRED sh.a. dhe CREDINS Invest sh.a. edhe gjatë vitit 2024, falë të cilit anëtarët e Fondit të Pensionit "Credins Pension" dhe të Fondit të Investimit "Credins Premium" përfituan falas:

1. Sigurimin Jetë dhe Aksidente për një vit!
2. Kartën e Sigurimit nga SiCRED.
3. Zbritje deri në 50% në 275 klinikat dhe spitalet e rrjetit mjekësor SiCRED.

Mbroni të dashurit tuaj dhe siguroni të ardhmen e tyre financiare me produktin tonë më të ri të sigurimit të jetës!

4.6 Bashkëpunimi me Bankën Credins

Gjatë vitit 2024, nisi zbatimi i një projekti të ri nga Banka Credins, për të gjithë klientët që tërheqin pensionin e pleqërisë përmes bankës. Kjo kategori përfitoi FALAS kartën e sigurimit SiCRED, e cila ofron:

- Deri në 50% zbritje në spitalet dhe klinikat më të njohura, pjesë të Rrjetit Mjekësor SiCRED.

Përveç kartës, përfituesit përfituan falas edhe:

- Sigurimin e jetës për një vit

4.7 Zgjerimi i Rrjetit Mjekësor SiCRED

Ofrimi i shërbimit mjekësor cilësor dhe në kohën e duhur, është qëllimi ynë për çdo person të siguruar në SiCRED. Ndaj, si pjesë e strategjisë sonë të zhvillimit të produkteve të sigurimit të shëndetit, kemi zgjerimin e rrjetit Mjekësor SiCRED, në mënyrë që çdo i siguruar, kudo që të jetë, të ketë akses mjekësor sa më pranë vendndodhjes së tij. Gjatë vitit 2024, kemi zgjeruar gjeografinë e spitaleve dhe klinikave bashkëpunëtoresh, me klinika dhe laboratorë të rinj në Shqipëri.

Në fund të 2024 rrjeti mjekësor SiCRED numëronte 275 klinika dhe spitale:

Brenda Republikës së Shqipërisë:

- 195 subjekte mjekësore (spitale private, klinika dhe laboratorë)

Jashtë Republikës së Shqipërisë:

- Kosovë – 8 spitale dhe klinika
- Itali – 3 spitale dhe një grup spitalor i përbërë nga 14 spitale dhe qendra mjekësore
- Austri – 5 klinika
- Turqi – 27 spitale dhe klinika
- Greqi – 23 spitale dhe klinika

Të gjithë të siguruarit tanë, të pajisur me kartën e sigurimit, mund të skanojnë në çdo moment kodin QR, që ndodhet në pjesën e pasme të kartës, për të aksesuar Rrjetin Mjekësor SiCRED.

4.8 Projekti “Videot Testimonial”

Gjatë vitit 2024, SiCRED ka finalizuar me sukses projektin “Videot Testimonial”, një angazhim që kishte si qëllim mbledhjen e një serie dëshmish autentike nga klientët tanë, të cilët kanë përfituar nga produktet tona të sigurimit. Dëshmitë u përqendruan në produktet: Sigurimi i Jetës dhe Aksidenteve, Sigurimi i Jetës dhe Shëndetit Cash Plan, Sigurimi i Jetës me Mbijetese dhe Sigurimi i Jetës Evolutive.

Klientët ndanë eksperiencat e tyre personale, duke treguar se si këto produkte i kanë ndihmuar të përballojnë sfidat e jetës dhe të sigurojnë mbështetje financiare për veten dhe familjet e tyre.

Përmes këtij angazhimi, SiCRED ka theksuar përkushtimin e saj për të ofruar produkte sigurimi që janë të përshtatshme për nevojat e klientëve dhe që kontribuojnë në sigurinë dhe mirëqenien e tyre afatgjatë. Videot shërbejnë gjithashtu si një mjet i rëndësishëm për edukimin e klientëve dhe rritjen e transparencës, duke i ndihmuar ata të bëjnë zgjedhje të informuara për mbrojtjen e të ardhmes së tyre.



4.9 Fushata “Jetë Evolutive”

Gjatë vitit 2024, SiCRED ka realizuar spotin e ri promovues për produktin “Jetë Evolutive”, konceptuar për të komunikuar në mënyrë të qartë dhe të afërt vlerën që ky produkt sjell për klientët

— duke e vendosur në qendër sigurinë financiare të familjes dhe mundësinë për të ndërtuar një të ardhme më të qëndrueshme.

Spoti është transmetuar në disa kanale mediatike dhe platforma digjitale, duke kontribuar në rritjen e ndërgjegjësisë për rëndësinë e sigurimit të jetës dhe promovimin e produkteve që u përshtaten ritmeve dhe nevojave të jetës moderne.

SIGURONI JETËN ME PRODUKTIN INOVATIV **JETË EVOLUTIVE!**

- ⚙️ GARANTONI TË ARDHMEN E FAMILJES SUAJ.
- ⚙️ PROCEDURA TË SHPEJTA, PRODUKT UNIK NË TREG.
- ⚙️ VETËM NGA SiCRED!

Për kë është ky sigurim?

Për prindërit që duan të mbrojnë të ardhmen e fëmijëve përballë të papriturave të jetës.

Për bizneset që investojnë në mirëqenien dhe stabilitetin e stafit të tyre.



www.sicred.com.al

Na ndiqni edhe në:



Kontakttoni me SiCRED

Tel: +355 4 22 37 549, Cel: +355 69 20 84 026
e-mail: contact@sicred.com.al



4.10 Përgjegjësia Sociale


SiCRED e konsideron përgjegjësinë sociale jo si një detyrim, por si një angazhim të natyrshëm ndaj komunitetit ku operon. Çdo veprim i ndërmarrë në këtë drejtim pasqyron vlerat tona si institucion financiar që kujdeset për mirëqenien jo vetëm të klientëve, por edhe të shoqërisë në tërësi. Nëpërmjet mbështetjes së iniciativave me ndikim kulturor, edukativ dhe social, synojmë të kontribuojmë në ndërtimin e një mjedisi më të drejtë, më të ndërgjegjshëm dhe më solidar për të gjithë.

4.10.1 Çmojmë së bashku trashëgiminë arkitekturore të Tiranës

Në kuadër të angazhimit tonë për të mbështetur kulturën dhe promovuar vlerat e trashëgimisë kombëtare, SiCRED ka kontribuar në realizimin e botimit të parë të Guidës Arkitekturore të Tiranës, hartuar nga arkitekti dhe studiuesi Eled Fagu.

Ky botim përbën një udhëtim gjithëpërfshirës përmes historisë arkitekturore të kryeqytetit, duke shpalosur tiparet dalluese të ndërtesave historike dhe zhvillimet më të fundit urbane që formësojnë pamjen e sotme të Tiranës. E konceptuar si një mjet orientues për banorët, turistët, studiuesit dhe të apasionuarit pas arkitekturës, guida ofron një pasqyrë të çmuar mbi evoluimin estetik dhe funksional të qytetit.

SiCRED vijon të mbështesë nisma që nxisin zhvillimin kulturor dhe forcimin e identitetit qytetar, në përputhje me vizionin tonë për një shoqëri më të lidhur me trashëgiminë e saj.



4.10.2 Mbështetje për talentin dhe përfaqësimin shqiptar në arenën ndërkombëtare

Gjatë vitit 2024, SiCRED pati kënaqësinë të mbështesë Federatën Shqiptare të Shahut në pjesëmarrjen e saj në Olimpiadën Botërore të Shahut, e zhvilluar në Budapest, në datat 10–23 shtator.

Jemi krenarë për përfaqësimin dinjitoz të Shqipërisë në një kompeticion ndërkombëtar ku strategjia, durimi dhe mendimi i thelluar janë në qendër të çdo lëvizjeje.

Le të vijojë ky rrugëtim me sa më shumë arritje dhe përfaqësime të suksesshme për Shqipërinë në arenën ndërkombëtare të sportit dhe mendimit.

4.10.3 Vrapojmë për një kauzë që na bashkon

Për të dytin vit radhazi, ekipi i SiCRED mori pjesë në Maratonën e Tiranës, duke mbështetur me zemër kauzën e Fondacionit Down Syndrome Albania.

Pjesëmarrja jonë nuk ishte thjesht një garë sportive, por një akt simbolik solidariteti dhe përkushtimi ndaj fëmijëve dhe familjeve që përballen me sfidat e sindromës Down.

Vrapuam me shpresën për të ndikuar pozitivisht në rritjen e ndërgjegjësimit dhe për të dhënë një kontribut domethënës për komunitetin tonë.



4.11 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Në themel të suksesit të SiCRED qëndrojnë punonjësit tanë. Ekipi ynë përbëhet nga profesionistë me eksperiencë të gjatë dhe të suksesshme në tregun e sigurimeve dhe më gjerë, të cilët janë formuar dhe trajnuar në institucione arsimore ndër më të mirat, brenda dhe jashtë vendit.

Fryma e bashkëpunimit, përkushtimi, energjia pozitive dhe mosha relativisht e re e stafit përbëjnë një kombinim që i ka dhënë forcë zhvillimit të shoqërisë ndër vite. Investimi i vazhdueshëm në burimet njerëzore është jo vetëm një vlerë e shtuar për shërbimet dhe produktet tona, por edhe një garanci për qëndrueshmërinë dhe rritjen në të ardhmen. Aftësitë, integriteti dhe përkushtimi i këtij ekipi kanë ndihmuar në ndërtimin e një reputacioni të qëndrueshëm në treg.

4.11.1 Të dhëna kyçe për burimet njerëzore të SiCRED (Dhjetor 2024):



4.11.2 Pjesëmarrje në Konferencën e 7-të të ELHUA në Amsterdam

Më 22–25 shtator 2024, përfaqësues nga stafi i SiCRED morën pjesë në Konferencën e VII të Shoqatës Europiane të Marrësve në Sigurim për Jetën dhe Shëndetin – 7th ELHUA Conference, e mbajtur në Amsterdam.

Konferenca mbledhi profesionistë nga e gjithë Europa për të ndarë zhvillimet më të fundit në fushën e sigurimeve të jetës dhe shëndetit, duke ofruar diskutime të thelluara mbi sfidat mjekësore, procesin e marrjes në sigurim dhe menaxhimin e rasteve të dëmit.

Pjesëmarrja në këtë aktivitet ndërkombëtar kontribuoi në përmirësimin e njohurive profesionale të stafit, duke reflektuar angazhimin e SiCRED për zhvillim të vazhdueshëm dhe përmirësim në ofrimin e shërbimeve.

4.11.3 Aktivitete me stafin

Në vitin 2024, vijuan traditën e organizimit të udhëtimeve për stafin, si një mundësi që jo vetëm forcon bashkëpunimin në ekip, por gjithashtu krijon kujtime dhe histori të reja që thellojnë lidhjet tona profesionale dhe njerëzore.

Çdo vit jemi mirënjohës për mundësinë për të kaluar kohë së bashku, duke përforcuar frymën e bashkëpunimit dhe besimit, që qëndron në themel të suksesit tonë të përbashkët. Ky bashkëpunim ka ndikuar jo vetëm në arritjet e SiCRED, por edhe në krijimin e një ambienti pune ku çdo individ ndihet i vlerësuar dhe i motivuar për të dhënë më të mirën.



5. OBJEKTIVAT E SHOQËRISË SICRED SH.A. PËR VITIN 2025

- **Menaxhimi i riskut dhe marrja në sigurim:** Synimi ynë dhe puna jonë e përditshme është menaxhimi me sukses i riskut, që lidhet me marrjen në sigurim. Ne synojmë të punojmë nën praktika të shëndosha të marrjes në sigurim, për të përcaktuar saktë riskun e individëve/grupeve, që aplikojnë për t'u siguruar, duke vendosur primin e përshtatshëm, të bazuar mbi faktorët moshë, gjendje shëndetësore, stil jetese dhe profesion. Objektivi ynë është balancimi i portofolit të të siguruarve.
- **Menaxhimi i kujdesshëm i kostove dhe rritja e fitimit:** Objektivi ynë është të ruajmë një raport të shëndetshëm mes shpenzimeve dhe të ardhurave, përmes menaxhimit efikas të kostove administrative dhe dëmeve, si dhe përcaktimit të primeve në përputhje me riskun e vlerësuar. Kjo ndihmon në rritjen e efikasitetit të produkteve dhe në përmirësimin e performancës financiare të kompanisë.
- **Shërbimi cilësor ndaj klientëve:** Për ne, mbajtja dhe kënaqësia e klientëve janë themel i qëndrueshmërisë. Angazhohemi të ofrojmë një shërbim të shpejtë, të qartë dhe të personalizuar, duke u përshtatur me nevojat specifike të çdo klienti dhe duke u përgjigjur në kohë reale në rastet e dëmeve apo kërkesave për informacion.
- **Zgjerimi i Rrjetit Mjekësor:** Synojmë të zgjerojmë më tej rrjetin tonë mjekësor, si në territorin shqiptar ashtu edhe jashtë tij, për të garantuar akses më të gjerë dhe cilësor në të gjitha specialitetet e mbuluara nga sigurimi. Zgjerimi i rrjetit synon mbështetjen praktike dhe financiare të të siguruarve tanë, kudo që ata zgjedhin të marrin shërbim mjekësor.
- **Inovacioni dhe përparimi teknologjik:** Për të qëndruar konkurrues dhe për të përmbushur nevojat në ndryshim të klientëve, vijojmë të investojmë në teknologji të reja. Objektivat përfshijnë përmirësimin e proceseve të brendshme, rritjen e përvojës së përdoruesit dhe zhvillimin e produkteve të reja që përmbushin standardet e tregut të sotëm.
- **Zhvillimi dhe trajnimi i punonjësve:** Burimi ynë më i rëndësishëm janë njerëzit tanë. Kemi në fokus zhvillimin e mëtejshëm të aftësive të tyre përmes trajnimeve të vazhdueshme, brenda dhe jashtë vendit, promovimin e një kulture pozitive pune, si dhe ofrimin e benefiteve që nxisin motivimin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë në kompani.
- **Zgjerimi i produkteve të jetës me komponentë investimi afatgjatë:** Duke ndjekur ritmin e zhvillimit të tregut financiar në vend, synojmë të ofrojmë produkte që sigurojnë rreziqet afatgjata të klientëve tanë si dhe ofrojnë siguri, garanci dhe maksimizim të kthimeve për kursimet e tyre afatgjata.
- **Promovimi dhe ndërgjegjësimi mbi produktet e sigurimit:** Për të mbështetur rritjen dhe edukimin financiar të publikut, jemi të përkushtuar në rritjen e pranisë sonë në kanalet e komunikimit. Synojmë të fokusohemi në promovimin e produkteve dhe vlerave tona, nëpërmjet fushatave informuese, edukative dhe ndërgjegjëse, me qëllim që të rrisim njohuritë e publikut mbi përfitimet që ofron sigurimi i jetës dhe shëndetit.

6. PËRMBLEDHËSE E SiCRED ASSISTANCE PËR VITIN E PËRMBYLLUR NË 31.12.2024



Të nderuar lexues, stafi i SiCRED Assistance, ka qenë plotësisht i përkushtuar për të adresuar sfidat e trazuara, të vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2024.

Megjithëse, plotësisht të dedikuar për të plotësuar standardet e përcaktuara në tregun tonë të punës, rezulton, se këtë vit jemi përballur me sfida serioze në ofrimin e shërbimeve ndaj klientëve tanë për shkak të lëvizjeve, presioneve financiare dhe nevojës për të menaxhuar një numër në rritje të punëdhënësve dhe punëmarrësve me kërkesa të standardit të sigurisë dhe shëndetit në punë, relativisht komplekse.

Duke i njohur vështirësitë, me të cilat përballlet tregu shqiptar i punës, pohojmë, se ne cilësinë e këshilluesit ligjor, i kemi njohur në detaje vështirësitë, që kanë përjetuar përgjatë vitit 2024, shumë punëdhënës, për shkak edhe të nevojës, që kanë prezantuar tek ne, për tu përballur me sfidat.

Strategjia jonë është përqendruar në mënyrën, se si mund ti ndihmojmë më shumë klientët tanë punëdhënës në problemet, që ata kanë në raport me menaxhimin e riskut të sigurisë dhe shëndetit në punë, me punonjësit tyre, lëvizjen e tyre, promovimin e tyre, vlerësimin e performancës, së riskut në ambientet e punës, si edhe ato të riskut në punën profesionale.

Qëllimi ynë në këshillimin e punëdhënësit është përqendruar fort në mënyrën, se si mund t'i ndihmojmë më shumë klientët tanë siç duhet, që në fillim, në çështjet e rreziqeve që shpërfaqen në mjediset e punës, duke zbatuar teorinë, që më mirë t'i shmangim rreziqet edhe jo ti zgjidhim problemet, pasi ato ndodhin.

Në mbështetjen e më shumë klientëve për t'u shërbyer, duke përdorur këtë strategji, kemi gjykuar, se kjo qasje, jo vetëm, që është më e mirë për klientët tanë punëdhënës, por ky orientim ndihmon, gjithashtu, t'u ofrojmë atyre shërbime më të mira në drejtim të përmirësimit të standardeve të punës, mjediseve në punë, në një tjetër nivel, përfshirë dhe trajtimin e streseve që vijnë nga puna apo në mjediset e punës.

Nën këtë frymë ne kemi përdorur burimet edhe kapacitetet tona njerëzore të shërbimit ndaj klientit-punëdhënës në mënyrën më efikase dhe produktive dhe i kemi orientuar burimet njerëzore të klientëve tanë punëdhënës në mënyrë më efektive, drejt nevojave më imediate për ndihmë edhe standard të lartë, në kushtet e mjediset e punës.

Si një autoritet ligjor, i përjasur me çdo të re, që ofron përshtatshmëria në këtë treg, ne kemi vepruar me besim, përgjatë 2024, si kujdestarë të sistemit të sigurisë edhe shëndetit në mjediset e punës për klientët tanë, duke u mundësuar klientëve, shërbim ligjor, këshillim ligjor cilësor në të gjitha disiplinat që na lejon objekti i aktivitetit tonë.

Kjo është mundësuar me ofrimin e këshillave për sigurinë dhe shëndetin në punë më të sigurta edhe që parandalojnë gabimet, duke përdorur të dhënat edhe eksperiencën e përfutur ndër vite.

Duke u ofruar klientëve tanë në formën e këshillimit ligjor të përshtatshëm, çështjet e tyre të sigurisë në mjediset e punës dhe rreziqet e profesionit në mënyrën më të mirë të mundshme, ne synojmë, qartësisht, jo vetëm identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve të sigurisë edhe shëndetit në mjediset e punës, por edhe ato të profesionit, duke e orientuar edhe pajtueshmërinë e tyre me standardin më të lartë.

Kjo është arsyeja, pse ne, si SiCRED Assistance po zgjerojmë dhe përmirësojmë vazhdimisht shërbimet tona në drejtim të këshillimit ligjor, në të gjitha disiplinat, që ne mbulojmë, në mënyrë që klientët, të mund të zgjidhin edhe të ndërmarrin veprime për të menaxhuar çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë.

E nderuar, që kam mundur të përcjell sfidat e një viti të vështirë, duke u mbështetur tek një staf i përkushtuar edhe profesional, pa devotshmërinë e te cilëve, nuk do të kishim në SiCRED ASSISTANCE këtë rezultat.

Me konsideratë dhe nderime,
Av. Vjosa Bodo Mujo

7. ECURIA E SHOQËRISË SI CRED DISTRIBUTION GJATË VITIT 2024



Fjala e administratorit

Viti 2024 ka qenë një vit i rëndësishëm për konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të biznesit tonë, duke ndjekur objektiva të qarta për zgjerim, modernizim dhe diversifikim të aktivitetit ekonomik. Në këtë fazë, është bërë një vlerësim i kujdesshëm i arritjeve të mëparshme dhe janë vendosur baza të forta për zhvillimin e qëndrueshëm në vitet në vijim.

Performanca përgjatë 2024

Zgjerimi në sektorin e Real Estate

Një ndër arritjet kryesore të këtij viti ishte përfshirja aktive e kompanisë në sektorin e pasurive të paluajtshme (real estate). Ky hap është ndërmarrë me synimin për të diversifikuar portofolin e investimeve dhe për të krijuar burime të reja të qëndrueshme të ardhurash. Janë identifikuar mundësi konkrete për investime dhe bashkëpunime, duke hapur rrugën për zhvillime të reja në këtë drejtim.

Platforma digjitale dhe baza për web të ri

Në linjë me nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të pranisë online dhe ndërveprimit me klientët, gjatë vitit 2024 është punuar intensivisht për ndërtimin e një platforme të re digjitale. Është vendosur struktura dhe përmbajtja fillestare për një faqe të re web, e cila do të reflektojë zhvillimet aktuale të markës dhe do të ofrojë një përvojë më të personalizuar dhe funksionale për përdoruesit.

Hapja e dyqanit online në Amazon

Një tjetër moment kyç i këtij viti ishte lancimi i dyqanit online në platformën Amazon, që përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt ndërkombëtarizimit të biznesit dhe rritjes së qasjes në tregje të reja. Përmes kësaj platforme është mundësuar një kanal i ri shitjeje, duke përforcuar prezencën tonë në tregun global dhe duke i dhënë konsumatorëve mundësinë të aksesojnë produktet tona në mënyrë të thjeshtë dhe efikase.

Parashikimi për Vitin 2025

Në vitin 2025, kompania synon të vazhdojë rrugën e zhvillimit të qëndrueshëm dhe inovacionit. Objektivat përfshijnë:

- Zgjerim të mëtejshëm në sektorin e real estate përmes projekteve konkrete dhe bashkëpunimeve strategjike;
- Finalizimin dhe lancimin e faqes së re web me funksionalitete të avancuara;
- Rritjen e kapaciteteve logjistike dhe operacionale për të përballuar fluksin në rritje nga shitjet online.
- Fuqizimin e pranisë së markës në tregje të huaja dhe zgjerimin e rrjeteve të shpërndarjes.

Këto masa do të shërbejnë si një bazë e fortë për të garantuar rritje të qëndrueshme, forcim të pozicionit në treg dhe krijim të vlerës afatgjatë

Onkita KODRA

8. DALJA NGA STRUKTURA AKSIONARE E SHOQËRISË “CREDINS INVEST”



Si pjesë e rishikimit dhe optimizimit të strategjisë së investimeve, gjatë vitit 2024, SiCRED ka përfunduar procesin e daljes nga struktura aksionare e shoqërisë “Credins Invest”, ku mbante 12% të aksioneve. Ky ndryshim i pronësisë ka ndodhur si pasoje e lëvizjeve të natyrshme në treg dhe si një hap strategjik për të përqendruar më tej burimet dhe investimet në fushat që lidhen drejtpërdrejt me aktivitetin kryesor të shoqërisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të saj.

Zgjidhja e kësaj pjesëmarrjeje aksionare u realizua në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me të gjitha kërkesat ligjore dhe rregullative në fuqi. SiCRED mbetet e përkushtuar ndaj një menaxhimi të kujdesshëm dhe të qëndrueshëm të aseteve dhe investimeve të saj, në përputhje me vizionin për zhvillim të qëndrueshëm dhe përgjegjshmëri financiare.

9. RAPORTI I AUDITIT TË BRENDSHËM

1 Baza ligjore

Njësia e Auditit të Brendshëm gjatë ushtrimit të veprimtarisë mbështetet në ligjet dhe aktet nën ligjore të mëposhtme me qëllim arritjen e objektivave në ushtrimin e funksionit të vet.

- Ligji Nr.52 datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit.
- Rregullorja “Për procedurat dhe parimet minimale në lidhje me kontrollin e brendshëm dhe aspekte të tjera të sistemit të informimit të shoqërisë së sigurimit” miratuar me vendim të Bordit të AMF nr. 135 datë 31.10.2014.
- Rregullorja “Për veprimtarinë e Njesisë së Auditit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit në shoqërinë e sigurimit” miratuar me vendim të Bordit të AMF nr. 153 datë 23.12.2014.
- Udhëzimi i Shoqërisë SiCRED sh.a. “Për veprimtarinë e Njesisë së Auditit të Brendshëm, Komitetit të Auditimit” miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 12, dt. 10.08.2015.
- Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” i ndryshuar.

2 Organizimi

● Misioni i Auditit të Brendshëm

Misioni i auditit të brendshëm është të mbështesë menaxhimin e lartë për kryerjen e përgjegjësi të tyre. Këtë mision auditi e realizon duke:

- Kryer kontrole të pavarura bazuar në standardet profesionale të miratuara.
- Kryen detyrat e veta funksionale sipas gjykimeve në mënyrë të pavarur.
- Ndihmuar menaxhimin, ofruar analiza, rekomandime këshillime dhe informacion të lidhur me njësitë që ka audituar.
- Mbështetur drejtuesit për arritjen e objektivave.

Njësia e auditit të brendshëm kryen funksione në mënyrë të pavarur dhe objektive duke dhënë një opinion të specializuar në funksion të përmirësimit të veprimtarisë së shoqërisë. Në përfundim të procesit të auditimit jepen rekomandime dhe propozime për të përmirësuar funksionimin aty ku rezulton e nevojshme.

● **Funksioni i Auditit të Brendshëm**

- Auditit i brendshëm përveç të tjerash përfshin krijimin, zbatimin dhe ruajtjen e një plani auditimi të bazuar në risk, për të shqyrtuar dhe vlerësuar fusha të përgjithshme apo të veçanta bazuar në masa parandaluese.
- Kryerjen e vlerësimeve të rregullta në funksion të auditit dhe auditimit të sistemeve të brendshme duke përfshirë përmirësimet e nevojshme.
- Siguron që fushat me risk janë subjekte të përzgjedhura të auditimit të përshtatshëm si kontabiliteti, politikat financiare, aftësia paguese, analiza e shpenzimeve, ngjarjet sigurimit dhe demet për t'u paguar ,etj.
- Siguron që risqet e identifikuar dhe veprimet e mara për t'i adresuar ato janë të sakta dhe aktuale.
- Auditit i brendshëm për të gjitha fushat dhe çështjet e shqyrtuara ka hartuar raporte për të siguruar dëshminë e tyre me kalimin e kohës.

● **Objekti i Auditit të Brendshëm**

Objekti i auditit të brendshëm konsiston në kontrole të thelluara dhe tematike, pranë drejtorive dhe degëve përkatëse në kohë dhe me efektivitet për të bërë të mundur vlerësimin e rreziqeve në kohë. Auditit i brendshëm përveç të tjerash përfshin krijimin, zbatimin dhe ruajtjen e një plani auditimi të bazuar në risk, për të shqyrtuar dhe vlerësuar fusha të përgjithshme apo të veçanta bazuar në masa parandaluese.

Auditit i brendshëm kontrollon dhe vlerëson sistemet e informacionit dhe raportimit duke përfshirë sistemet e teknologjisë si dhe informacionit dhe saktësinë e të dhënave.

Siguron që risqet e identifikuar dhe veprimet e mara për t'i adresuar ato janë të sakta dhe aktuale si dhe sistemi i administrimit të rrezikut është zbatuar nga shoqëria.

Kryerjen e vlerësimeve të rregullta në funksion të auditit dhe auditimit të sistemeve të brendshme duke përfshirë përmirësimet e nevojshme.

Siguron që fushat me risk janë subjekte të përzgjedhura të auditimit të përshtatshëm si kontabiliteti, politikat financiare, aftësia paguese, analiza e shpenzimeve, ngjarjet sigurimit dhe demet për t'u paguar etj.

Në përcaktimin nëse sistemi i shoqërisë SiCRED sh.a. për proceset e menaxhimit të riskut, kontrollit të hartuara dhe të paraqitura nga menaxhimi janë adekuate dhe funksionojnë në mënyrë që garantojnë se:

- Informacioni financiar, menaxherial dhe operacional është i saktë dhe i besueshëm në kohë.
- Risqet identifikohen dhe menaxhohen në mënyrën e duhur.
- Burimet sigurohen dhe përdoren me evidencë.
- Ndërveprim midis drejtorive, sektorëve dhe degëve në rrethe.
- Kryerja e detyrave nga punonjësit janë në përputhje me politikat, standardet, procedurat dhe ligjet e rregulloret në fuqi.
- Përmirësim i vazhdueshëm në procesin e kontrollit të brendshëm.
- Çështjet e rëndësishme legislative dhe rregullatorë që kanë ndikim në shoqërinë SiCRED sh.a janë pranuar dhe adresuar siç duhet.

Auditit i brendshëm për të gjitha fushat dhe çështjet e shqyrtuara gjatë vitit 2024 ka hartuar raporte për të siguruar dëshminë e tyre me kalimin e kohës.

● **Organizimi i Burimeve Njerëzore dhe Financiare të Auditit të Brendshëm**

Auditit i brendshëm vepron në zbatim të ligjit nën cilësinë e një strukture të posaçme. Auditit i brendshëm është punonjës i shoqërisë i emëruar në Njësinë e Auditit të Brendshëm. Komiteti i Kontrollit të Brendshëm ka në përbërje dy punonjës të miratuar nga Këshilli Mbikqyrës. Njësia e Auditit ushtron

detyrën në mënyrë të pavarur dhe të integruar duke vlerësuar procesin e qeverisjes, administrimit të rrezikut brenda shoqërisë. Auditimet për vitin 2024 janë kryer nga një auditues i emëruar nga Këshilli Mbikqyrës. Audituesi i brendshëm i Shoqërisë ka profil ekonomist dhe një përvojë pune prej 22 vitesh në fushën e sigurimeve. Angazhimi në shoqërinë SiCRED sh.a në rolin e auditit të brendshëm është prej 14 vjetësh. Gjatë këtyre viteve auditit ka ndjekur trajnimet profesionale të auditit "Audit ekonomik –Financiar" dhe të standarteve të kontabilitetit, IFRS 17 si dhe trajnime në lidhje ndryshimet që pësojnë ligjet e kontabilitetit dhe ato fiskale. Audituesi ekziston i regjistruar në regjistrin ekspertëve fiskal me nr. 184 që prej vitit 2012. Eksperienca e gjatë në fushën e sigurimeve dhe atë financiare ndihmon në realizimin me profesionalizëm të punës brenda Shoqërisë. Në fushën e auditimit, auditimet e brendshëm janë kryer në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe në mbështetje të programit vjetor të miratuar nga Këshilli Mbikqyrës. Njësia e auditit të brendshëm është njohur dhe përshtatur me kërkesat në ndryshim të ligjeve dhe rregulloreve të brendshme.

3 Analiza e Veprimtarisë së Auditit të Brendshëm

Gjatë vitit 2024 Auditit i brendshëm ka ushtruar veprimtarisë e tij duke u bazuar në planit vjetor të miratuar nga Këshilli Mbikqyrës. Kontrollat janë zhvilluar sipas tematikave duke u fokusuar në analizën e proceseve, risqeve dhe të dhënave të grumbulluara në dokumentacionin që shoqëria SiCRED sh.a. përdor. Gjithsej vitit 2024 janë kryer 15 misione auditimi. Auditimi ka qenë i plotë ose i pjesshëm në varësi të tematikave. Auditimet e kryera janë përqendruar kryesisht në zyrat qendrore ku SiCRED sh.a. zhvillon veprimtarinë por dhe në degët e shoqërisë. Për sa u përket auditimeve janë marrë parasysh treguesit me rrezik të lartë në mënyrë që t'u paraprihet problematikave që mund të ndodhin në kohë. Gjithashtu auditime janë kryer në zbatim të rekomandimeve të lëna si dhe problematikave që mund të kenë dalë gjatë punës së përditshme.

Gjithashtu janë kryer dhe auditime të cilat nuk kanë qenë planifikuar por që kanë dalë si të nevojshme për t'u kryer gjatë periudhës së vitit 2024. Në fund të çdo raporti janë lënë rekomandimet përkatëse. Të gjitha rekomandimet e dhëna nga auditimi janë pranuar nga drejtuesit.

4 Pohimi i pavarësisë

Auditimi i brendshëm kryhet sipas kuadrit ligjor e rregullator dhe nuk i është nënshtruar asnjë ndikimi tjetër nga individë qofshin dhe në pozicion drejtues brenda shoqërisë. Puna e auditit të brendshëm ka qenë në përputhje me politikën ligjore dhe rregullat për pajtueshmërinë ligjore. Audituesi i brendshëm respekton rregullat e etikës dhe të sjelljes brenda shoqërisë. Audituesi mban qëndrim të paanshëm dhe i shmanget konfliktit të interesit. Auditit i brendshëm si funksion themelor për sistemin e kontrollit të brendshëm në Shoqërinë SiCRED sh.a. ka funksionuar si një njësi e pavarur që prej krijimit të Shoqërisë. Në përshtatje të formës dhe funksionimit është ngritur njësia e auditit të brendshëm në përputhje me rregulloren e miratuar. Referuar një programi metodologjik, kronologjik, gjithëpërfshirës adekuat auditit ka raportuar me shkrim dhe me efektivitet punën e kryer pa u ndikuar nga organizimi. Audituesi ka shfaqur nivel të lartë të gjykimit profesional në mbledhjen vlerësimit dhe transmetimin e informacionit mbi proceset që janë audituar. Auditit ka ushtruar kontroll pa u influencuar nga interesat personale.

5 Plani i auditimit për vitin 2025

Objektivat e planit të auditimit për vitin 2025 do të arrihen nëpërmjet harmonizimit të kontrolleve të thelluara dhe tematike, duke kryer vlerësimin e rreziqeve në kohë dhe me efektivitet. Në përcaktimin e risqeve me të cilat do të haset shoqëria gjatë vitit 2025 do të bazohet kryesisht në risqet e hasura gjatë vitit të shkuar si dhe në rekomandimet e dhëna nga organet rregullatore. Auditimi përfshin dhe menaxhimin e risqeve të sigurimit dhe risigurimit, riskun financiar dhe të kontabilitetit, riskun ligjor, riskun në lidhje me ngjarjet e sigurimit. Për sa i përket menaxhimit të riskut Shoqëria "SiCRED sh.a" ka ngritur Komitetin e Administrimit të Riskut. Komiteti i Administrimit të Riskut vepron në zbatim të ligjit nën e cilësinë e një strukturë të posaçme dhe funksionon si njësi në mënyrë të pavarur dhe objektive duke dhënë opinion të specializuar në funksion të përmirësimit të veprimtarisë së shoqërisë. Në mbledhjen e komitetit të auditimit të zhvilluar më datë 30.12.2024 është shqyrtuar programi i auditimit për vitin 2025 i cili është miratuar me vendimin e këshillit mbikqyrës nr.8 datë 05.12.2024.

Për vitin 2025 puna audituese do të përfshijë drejtoritë dhe degët si më poshtë:

1. Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit.
2. Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore.
3. Drejtoria e Marrjes në Sigurim dhe Korporatave.
4. Drejtoria e Administrimit dhe Aktuaristikës.
5. Sektorit i Administrimit të Rrjetit të Degëve dhe It-së.
6. Drejtoria së Shitjeve dhe Dega Tiranë.
7. Degët në rrethe.

Gjithashtu auditimi përfshin dhe menaxhimin e risqeve të mëposhtme:

Riskun e sigurimit dhe risigurimit
Riskun financiar dhe të kontabilitetit
Riskun ligjor
Riskun në lidhje me ngjarjet e sigurimit

Kontrolle me risk të lartë

- Analiza e shpenzimeve operative dhe minimizimi i shpenzimeve që kanë efekt në rezultatin e shoqërisë duke mbajtur parasysh nivelin e pranueshëm dhe të krahasueshëm me normën e tregut.
- Norma e likuiditetit dhe mbajtja në nivelin e kërkuar.
- Aftësia paguese, provigjionet teknike, aktivet në mbulim të provigjioneve.
- Administrimin e policave të shitura të sigurimit, rakordimi i primeve me kontabilitetin.
- Implementimi i programit të integruar.

Kontrolle me risk të mesëm

- Treguesve kryesorë të pasqyrave financiare, raportet statistikore dhe kontabël, analiza e shpenzimeve administrative dhe ato të marrjes në sigurim, analiza e zërave të veçantë të pasqyrave financiare.
- Kontroll i kërkesave për arkëtim dhe detyrimeve të debitorëve, mosha e krijimit të tyre, afatet e pagesave si dhe arkëtimi i tyre në kohë.
- Administrimi i policave të shitura të sigurimit, rakordimi i primeve me kontabilitetin, llogaritja e shpenzimeve të marrjes në sigurim, zbatimi i udhëzimit të marrjes në sigurim.
- Praktikat e ngjarjeve të sigurimit, zbatimi i ligjit dhe i udhëzimeve të brendshme, likuidimi i tyre.
- Procedurat e blerjeve dhe shpenzimet që lidhen me to.
- Komisionet e dhëna (agjent, broker në sigurime).
- Përditësimi i udhëzimeve të marrjes në sigurim për produktet jeta për hua, jetë dhe shëndet, jeta me kursim, jetë dhe aksidente.
- Marrja në sigurim, tarifimi dhe administrimi i produkteve të sigurimit të jetës, kontratat e bashkësigurimit, kontratat fakultative.
- Inventarizimi i policave të shitura dhe ato gjendje si në qendër dhe në degët ku ushtrohet aktiviteti i shoqërisë.
- Zbatimi i procedurave të ruajtjes dhe administrimit të policave të sigurimit si dhe vlerave të tjera monetare dhe materiale, dokumentimi i tyre.
- Parandalimi të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
- Ndjekja e rekomandimeve.

Kontrolle me risk të ulët

- Procedura e rekrutimit të punonjësve të rinj.
- Vendimet e rekrutimit dhe largimit.
- Vlerësimi i performancës.
- Pagesa e punës, kohëshënuesi i punonjësve, shpërblimet e stafit.
- Inventarizimi në degë.
- Administrimi i policave që anulohen.
- Ndjekja e rekomandimeve.

6 Opinioni i Njesisë së Auditit të Brendshëm

Njësia e Auditit të Brendshëm ka realizuar detyrat e planifikuara bazuar në planin e auditit të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës për vitin 2024. Për çdo kontroll të kryer janë nxjerrë konkluzionet dhe atje ku janë konstatuar elementë për t'u përmirësuar janë dhënë rekomandimet të cilat janë pranuar nga drejtimi.. Njësia e Auditit duke kryer procedurat dhe verifikimet përkatëse ka ndikuar në identifikimin, kontrollin dhe administrimin e risqeve që mbulon secila drejtori apo degë. Gjatë kryerjes së aktivitetit të auditit të brendshëm nuk janë evidentuar gjetje apo gabime me impakt të lartë në aktivitetin e Shoqërisë. Pavarësisht të dhënave për përmirësim është vërejtur një nivel i kënaqshëm i kontrolleve të realizuara për gjatë vitit 2024.

Njësia e Auditit të Brendshëm
Matilda THOMA



SiCRED sh.a.

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
me raportin e Audituesit të pavarur

PËRMBAJTJA

OPINIONI I AUDITIT TË JASHTËM	32
PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR	35
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	36
PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	37
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSEVE TË PARASË	38
SHËNIME TË PASQYRAVE TË KONSOLIDUARA FINANCIARE	39

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Për Drejtimin e Shoqërisë SICRED sha

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të SiCRED sha ("Grupi"), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2024, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza per opinionin

Ne kryem auditimin tone ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Auditimit (SNA-te). Pergjegjesite tona sipas ketyre standardeve jane pershkruar ne menyre me te detajuar ne seksionin e raportit ku jepen Pergjegjesite e Audituesit per Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi te pavarur nga Shoqeria ne perputhje me Kodin e Etikes per Profesionistet Kontabel te Bordit te Standardeve Nderkombetare te Etikes per Profesionistet Kontabel (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikes te Institutit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar ne Shqiperi (Kodi i IEKA) qe jane te zbatueshme per auditimin e pasqyrave financiare ne Shqiperi, dhe kemi permbushur pergjegjesite e tjera etike ne perputhje me keto kerkesa.

Ne besojme se evidenca e auditimit qe kemi siguruar eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te dhene nje baze per opinionin tone.

Informacioni tjetër

Drejtimi është përgjegjës për informacionin tjetër. Informacioni tjetër përfshin informacionin qe jepet ne Raportin Vjetor, të përgatitur nga drejtimi, dhe nuk përfshijnë pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportin tone të auditimit mbi to.

Raporti ynë mbi këto pasqyra financiare të konsoliduara nuk mbulon informacionin tjetër dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj tjetër konkluzioni qe jep siguri mbi to.

Ne lidhje me auditimin tone të pasqyrave financiare të konsoliduara, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionin tjetër dhe, gjatë këtij procesi, të konsiderojmë nëse informacioni tjetër është në mënyre materiale jo konsistent me pasqyrat financiare të konsoliduara ose me njohuritë e përfituara gjatë auditimit ose nëse në dukje është në mënyre materiale i gabuar.

Nëse, bazuar në punën qe ne kemi kryer, ne arrijmë në përfundimin se ka gabime material në informacionin tjetër, atëherë ne duhet ta raportojmë këtë fakt. Në datën e lëshimit të këtij raporti, Grupi akoma nuk e ka publikuar informacionin tjetër. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në lidhje me të.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdoje Grupin ose të ndërprerë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternative tjetër reale përveç sa me sipër.

Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidence auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është me i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të beje me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Grupit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marre, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Grupit për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesve në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare të konsoliduara, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë.

Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marre deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Grupi të ndërpresë veprimtarinë.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në lidhje me to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Nexia AL shpk

Auditues Ligjor
Orjana Kalaja

Tirana, Albania
4 prill 2025



PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR

më 31 dhjetor 2024 (Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2024 në LEK	31 dhjetor 2023 në LEK
AKTIVET			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	6	23,811,596	20,810,615
Mjete monetare të kushtëzuara	7	115,105	100,000
Depozita me afat me bankat	8	507,882,574	471,960,665
Investime në letra me vlerë	9	174,093,884	175,950,987
Llogari të arkëtueshme sigurimi dhe risigurimi, neto	10	43,141,030	43,578,415
Aktive të risigurimit	11	21,604,225	19,503,331
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	12	17,108,304	14,521,423
Tatim fitimi i parapaguar		1,901,874	-
Aktive të tjera	13	17,151,789	12,637,785
Investime në pjesëmarrje	14	-	12,739,136
Aktive afatgjata materiale	15	33,995,711	33,887,415
Aktivë në përdorim	15	21,399,656	32,068,018
Aktive afatgjata jomateriale	16	991,653	7,152,700
Totali i aktiveve		863,197,400	844,910,490
DETYRIMET			
Rezervat për primet e pafituar	17	130,369,954	132,768,340
Rezerva për humbjen dhe rregullimi i shpenzimeve të humbjes	18	36,077,208	28,497,202
Rezerva matematikore	19	121,754,403	98,298,989
Llogari të pagueshme për sigurimet dhe risigurimet	20	18,272,483	20,392,072
Detyrime për qira për aktivet në përdorim	21	20,324,421	31,430,628
Detyrimi për tatim fitimin	33	-	3,424,900
Detyrim tatimor i shtyrë	34	-	100,603
Detyrime nga institucionet financiare	22	4,934,826	6,926,825
Detyrime të tjera	23	32,658,725	12,763,183
Totali i detyrimeve		364,392,020	334,602,742
KAPITALI			
Kapitali aksionar	24	498,293,927	498,293,927
Humbje të mbartura		(5,334,406)	(4,299,767)
Fitimi i periudhës		5,845,860	16,313,588
Totali i kapitalit		498,805,381	510,307,748
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		863,197,401	844,910,490

Shënimet shpjeguese në faqet 39 - 70 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

PASQYRA E KONSOLIDUAR E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE

për periudhën që mbyllet me 31 dhjetor 2024 (Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Prime të shkruara bruto	25	334,884,760	297,608,152
Prime të çeduar në risigurim	26	(22,395,076)	(19,109,773)
Të ardhura bruto nga prime të shkruara		312,489,684	278,498,379
Ndryshimi në rezervat për primet e pafituar	17	2,398,385	20,416,946
Ndryshimi në rezerva matematikore	19	(23,455,414)	(14,151,336)
Ndryshimi në rezervën e primit të risiguruesit	11	2,100,893	8,556,531
Ndryshimi në kosto të shtyra të marrjes në sigurim	12	2,586,881	(6,368,239)
Të ardhura neto nga prime të shkruara		296,120,429	286,952,281
Të ardhura nga interesi	27	25,041,051	25,314,127
Te ardhura nga shitja e aksioneve		2,186,931	-
Fitimi nga investime në pjesëmarrje		2,065,889	1,600,224
Shpenzime interesi		(1,673,176)	(2,481,580)
Fitim/ (Humbje) nga kurset e këmbimit	32	(10,269,626)	(16,941,697)
Të ardhura të tjera		14,053,396	8,336,213
Të ardhurat neto		327,524,894	302,779,568
Dëme të paguara të sigurimit	28	(69,761,478)	(48,869,391)
Dëme të sigurimit neto		(69,761,478)	(48,869,391)
Kostot e marrjes në sigurim	29	(106,110,230)	(93,752,519)
Shpenzime personeli	30	(82,038,104)	(78,466,321)
Shpenzime administrative	31	(42,428,122)	(40,371,734)
Shpenzime amortizimi	15,16	(18,296,195)	(19,480,351)
Total shpenzime operative		(318,634,129)	(280,940,316)
Fitimi i vitit para tatimit		8,890,765	21,839,252
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	33	(3,044,905)	(5,481,668)
(Shpenzimi) / përfitimi nga detyrimi tatimor i shtyrë	34	-	(43,996)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(3,044,905)	(5,525,664)
Fitimi i vitit pas tatimit		5,845,860	16,313,588
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		5,845,860	16,313,588

Shënimet shpjeguese në faqet 39 - 70 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara..

PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

për periudhën që mbyllet me 31 dhjetor 2024 (Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Kapitali themeltar	Fitime të mbartura	Fitimet e vitit	Totali
Gjendja me 31 dhjetor 2022	490,062,000	3,799,510	8,013,319	501,874,829
Rritje kapitali	8,231,927	(8,231,927)	-	-
Fitimi i vitit	-	-	16,313,588	16,313,588
Totali i fitimeve/humbjeve të akumuluarra për periudhën	-	-	-	-
Transferim i fitimit të vitit në fitimet e pashpërndara		8,013,319	(8,013,319)	-
Dividendi për tu shpërndarë	-	(7,880,669)	-	(7,880,669)
Gjendja më 31 dhjetor 2023	498,293,927	(4,299,767)	16,313,588	510,307,748
Rritje kapitali	-	-	-	-
Fitimi i vitit	-	-	5,845,860	5,845,860
Totali i fitimeve/humbjeve të akumuluarra për periudhën	-	16,313,588	(16,313,588)	-
Transferim i fitimit të vitit në fitimet e pashpërndara	-	-	-	-
Dividendi për tu shpërndarë	-	(17,348,228)	-	(17,348,228)
Gjendja më 31 dhjetor 2024	498,293,927	(5,334,406)	5,845,860	498,805,380

Shënimet shpjeguese në faqet 39-71 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara. Pasqyrat financiare të konsoliduara u aprovuan nga drejtimi i Shoqërisë SiCRED sha, me 4 prill 2025 dhe u firmosen nga:

Z. Genc Koxhaj

Drejtor i Përgjithshëm



Znj. Teuta Locaj

Drejtor i Financës

PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSEVE TË PARASË

për periudhën që mbyllet me 31 dhjetor 2024 (Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Fluksi i parasë nga aktivitete operative		
Fitimi pas tatimit	5,845,860	16,313,588
Rregullime për:		
Shpenzime amortizimi aktivë të trupëzuara	18,296,195	19,480,351
Rezervat për primet e pafiturar	(2,398,386)	(20,416,946)
Rezerva për humbjen dhe rregullimi i shpenzimeve të humbjes	7,580,006	(3,587,273)
Rezerva matematikore	23,455,414	14,151,336
Shpenzime për interesin	1,673,176	2,481,580
Të ardhura nga interesi	(25,041,051)	(25,314,127)
Fluksi i parasë përpara ndryshimeve në aktive dhe detyrime	29,411,215	3,108,509
Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operative:		
Mjete monetare të kushtëzuara	(15,105)	-
Depozita me afat me bankat	(35,921,909)	3,976,754
Aktive financiare të mbajtura për shitje	-	-
Llogari të arkëtueshme sigurimi dhe risigurimi, neto	437,385	(2,742,114)
Aktive të risigurimit	(2,100,894)	(8,556,531)
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	(2,586,881)	6,368,239
Tatim fitimi i parapaguar	(1,901,874)	-
Aktivi tatimor i shtyrë	-	-
Aktive të tjera	(4,514,004)	1,537,597
Investime në pjesëmarrje	12,739,136	(1,278,503)
Interes i paguar	(1,673,176)	(2,481,580)
Llogari të pagueshme sigurimi dhe risigurimi	(2,119,589)	3,465,030
Detyrimi për tatim fitimin	(3,424,900)	3,063,681
Detyrim tatimor i shtyrë	(100,603)	(43,996)
Detyrime të tjera	19,895,542	2,616,163
Flukset monetare të përdorura nga aktivitetet operative	8,124,344	9,033,249
Flukset monetare nga aktivitetet investuese		
Interesi i arkëtuar	25,041,051	25,314,127
Shtesa te aktiveve afatgjata materiale	(108,295)	(2,296,923)
Shtesa te aktiveve në përdorim	(7,627,834)	-
Shtesa te aktiveve afatgjata jomateriale	6,161,047	-
Pakësime te aktiveve afatgjata jomateriale	-	2,049,657
Investime në letra me vlerë	1,857,103	(16,865,980)
Flukset monetare të gjeneruara/ (të përdorura) nga aktivitetet investuese	25,323,071	8,200,881
Flukset monetare nga aktivitetet financuese		
Detyrime për qira për aktivet në përdorim	(11,106,207)	(15,315,806)
Detyrime ndaj institucioneve financiare	(1,991,999)	(3,072,299)
Dividend	(17,348,228)	(7,880,669)
Flukset monetare të gjeneruara/ (të përdorura) në aktivitetet financuese	(30,446,434)	(26,268,774)
Rritje neto për mjetet monetare dhe ekuivalente	3,000,981	(9,034,644)
Mjete monetare dhe ekuivalente në fillim të vitit	20,810,615	29,845,259
Mjete monetare dhe ekuivalente në fund të vitit	23,811,596	20,810,615

Shënimet shpjeguese në faqet 39 - 70 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM

SiCRED sh.a. (tani e tutje do i referohemi si "Shoqëria") është themeluar në 7.10.2003, dhe është regjistruar në 30.9.2004 si një shoqëri sigurimi jete me seli në Tiranë në adresën Rruga Brigada VIII, Nr.3/1.

Shoqëria është një shoqëri aksionare me kapital të përbashkët, e regjistruar sipas ligjit nr.7638, datë 19 nëntor 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë me vendim të Gjykatës së Rrethit të Tiranës, Nr. 30417, datë 22.10.2003, dhe e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër unik të identifikimit K42201801Q.

Shoqëria operon sipas licencës të lëshuar nga Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare (tani e tutje do i referohemi si "AMF"), për të ushtruar veprimtari sigurimi të jetës në përputhje me ligjin nr.52/2014, datë 22.5.2014 "Për veprimtarinë e Sigurimit dhe të Risigurimit", si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, në fushën e sigurimeve të jetës. Autorizimi për të ndërmarrë aktivitetet e sigurimit të jetës është marrë nga AMF me anë të Vendimit Nr. 9, datë 26.7.2004.

Shoqëria ka degë në qytetet: Tiranë dhe Durrës (31 dhjetor 2023: Tiranë, Durrës, Shkodër, dhe Korçë).

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë gjatë vitit 2024 deri në nënshkrimin e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara janë:

- Z. Artan Xhori - Kryetar
- Z. Selman Lamaj - Anëtar
- Z. Egi Santo - Anëtar

Kapitali aksionar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 është në vlerën 498,293,927 Lekë dhe përbëhet nga 498,294 aksione me vlerë nominale prej 1,000 Lekë për aksion dhe zotërohet nga aksionarët si vijon:

	31 dhjetor 2024		31 dhjetor 2023	
	në %	Numri i aksioneve	në %	Numri i aksioneve
Aleksandër Pilo	46.39%	231,152	46.39%	231,152
Renis Tërshana	30.16%	150,274	30.16%	150,274
Monika Milo	4.75%	23,664	4.75%	23,664
Maltin Korkuti	4.75%	23,664	4.75%	23,664
Kristino Kromidha	4.05%	20,199	4.05%	20,199
Egi Santo	2.37%	11,832	2.37%	11,832
Emi Santo	2.37%	11,832	2.37%	11,832
Arben Taipi	2.06%	10,271	2.06%	10,271
Petra Shomo	2.06%	10,271	2.06%	10,271
Artan Xhori	1.03%	5,135	1.03%	5,135
	100.00%	498,294	100.00%	498,294

Shoqëria zotëron këto investime në Shoqëri të tjera:

- Credins Invest sh.a. Shoqëri Administruese e Fondeve ku SiCRED sh.a. zotëron 0% të aksioneve (31 dhjetor 2023: 12% të aksioneve);
- SiCRED Assistance, e themeluar ne 29 qershor 2012, ku SiCRED sh.a. zotëron 100% të aksioneve (31 dhjetor 2023: 100% të aksioneve);
- SiCRED Distribution, e themeluar në 18 shkurt 2021, ku SiCRED sh.a. zotëron 100% të aksioneve (31 dhjetor 2023: 100% të aksioneve).

Selia kryesore e Shoqërisë është në Tiranë, Rruga Brigada VIII, Vila nr. 3/1. Me 31 dhjetor 2024, Shoqëria kishte 46 punonjës (31 dhjetor 2023: 52).

1. Përshkrim i përgjithshëm (vazhdim)

Shoqëria zotëron këto investime në Shoqëri të tjera me 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023:

	31 dhjetor 2024		31 dhjetor 2023	
	në %	Vlera Kontabël e Investimit	në %	Vlera Kontabël e Investimit
Credins Invest sh.a. Fund Management Company	-	-	12.00%	10,837,191
SiCRED Assistance	100.00%	1,801,945	100.00%	1,801,945
SiCRED Distribution	100.00%	100,000	100.00%	100,000
		1,901,945		12,739,136

2. BAZAT E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"), si edhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 52 "Për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve". Shoqëria përgatit pasqyra financiare të veçanta dhe të konsoliduara. Shoqëria ka investime në njësi ekonomike të tjera siç paraqiten në shënimin 1, dhe përgatit pasqyra financiare të konsoliduara sipas kërkesave të SNRF 10 dhe SNK 28. Pasqyrat financiare të konsoliduara u aprovuan nga drejtimi i Shoqërisë SiCRED sha, me 4 prill 2025, dhe u autorizuan për aprovim nga Këshilli Mbikëqyrës i saj.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

2.3 Monedha funksionale dhe ajo e prezantimit

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë paraqitur në Lek Shqiptar që është monedha funksionale dhe prezantuese e Shoqërisë dhe të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek përveç se kur është shprehur ndryshe

2.4 Parimi i vijimësisë

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijimësisë dhe nuk përfshijnë ndonjë rregullim të vlerës kontabël dhe klasifikimit të aktiveve, pasiveve dhe shpenzimeve të raportuara që përndryshe mund të kërkojnë nëse baza e parimit të vijimësisë nuk do të ishte e përshtatshme.

Drejtimi i Shoqërisë beson se ka aktive të mjaftueshme dhe se ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar qëndrueshmëri dhe zhvillim të biznesit në kushtet aktuale.

2.5 Gjykimet kontabël dhe vlerësimet

Përgatitja e pasqyrave financiare të konsoliduara, kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në vlerën e mbartur të aktiveve dhe detyrimeve, si edhe të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën kur këto vlerësime rishikohen dhe gjithashtu në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

3. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME

Standarde Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara. Standardet e reja në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024 dhe që nuk kanë një efekt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë:

- Detyrimet afatgjata me marrëveshje – Ndryshime në SNK 1, 1 janar 2024;
- Klasifikimi i pasiveve si korrente ose afatgjata – Ndryshimet në SNK 1, 1 janar 2024;
- Detyrimi i qirasë në shitje dhe kthim me qira – Ndryshimet në SNRF 16, 1 janar 2024;
- Marrëveshjet financiare të furnizuesit – Ndryshimet në SNK 7 dhe SNRF 7, 1 janar 2024.

Standardet dhe interpretimet e publikuara, por të pazbatueshme ende për periudhën vjetore që fillon më 1 janar 2024

- Mungesa e shkëmbyeshmërisë – Ndryshimet në SNK 21, 1 janar 2025;
- Shitja ose kontributi i aktiveve ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët – Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28, E disponueshme për adoptim opsional / data e hyrjes në fuqi e shtyrë për një kohë të pacaktuar.

SNRF 17 “Kontratat e Sigurimeve” (në fuqi më ose pas 1 janarit 2023)

SNRF 17 zbatohet për të gjitha llojet e kontratave të sigurimit (d.m.th., sigurimi i jetës, jo-jetës, sigurimi i drejtpërdrejtë dhe ri-sigurimi), pavarësisht nga lloji i njësive ekonomike që i lëshojnë ato, si dhe për disa garanci dhe instrumente financiare me karakteristika të pjesëmarrjes diskrecionale.

SNRF 17 ofron një model gjithëpërfshirës për kontratat e sigurimit, duke mbuluar të gjitha aspektet përkatëse të kontabilitetit. Thelbi i SNRF 17 është modeli i përgjithshëm, i plotësuar nga:

- Një përshtatje specifike për kontratat me tipare të pjesëmarrjes direkte (qasja e tarifës së ndryshueshme)
- Një qasje e thjeshtuar (qasja e alokimit të primit) kryesisht për kontratat me kohëzgjatje të shkurtër.

Shoqëria është duke ndërmarrë hapa për të bërë të mundur zbatimin e kërkesave që lindin nga hyrja në fuqi e këtij standardi për periudhën e ardhshme financiare, sipas afateve të përcaktuara nga autoritetet lokale.

a) Filialet dhe konsolidimi

Filialet janë subjekte të kontrolluara nga shoqëria. Kontrolli ekziston kur shoqëria ka fuqinë, drejtpërdrejt ose indirekt, që të qeverisë politikat financiare dhe operative të një njësie ekonomike në mënyrë që të marrë përfitime nga aktivitetet e saj. Në vlerësimin e kontrollit merren parasysh të drejtat potenciale të votimit që aktualisht janë të ushtrueshme ose të konvertueshme.

Shoqëria SiCRED sha, përgatit pasqyra financiare të konsoliduara dhe individuale të disponueshme për përdorim publik që përputhen me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”).

Investimet në filiale në këto pasqyra financiare të konsoliduara kontabilizohen me kosto. Më shumë detaje mbi investimet në filiale janë dhënë në Shënimin 14.

Më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 Shoqëria kontrollon shoqërinë SiCRED Assistance dhe SiCRED Distribution, ku ajo zotëron 100% të aksioneve të tyre.

Investimet testohen për zhvlerësim sa herë që ka tregues se vlera e mbetur kontabël e tij mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse shuma e rikuperueshme e një investimi (vlera më e lartë midis vlerës së drejtë minus koston e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim) është më e vogël se vlera kontabël e saj, vlera kontabël neto reduktohet në shumën e rikuperueshme.

Vlera kontabël e një investimi çregjistrohet gjatë nxjerrjes jashtë përdorimit. Diferenca midis vlerës së drejtë të fitimit nga shitjet dhe pjesës së mbetur të vlerës kontabël neto të investimit njihet në fitim ose humbje si fitim ose humbje nga shitja. E njëjta gjë vlen edhe nëse nxjerrja jashtë përdorimit rezulton në kalimin nga filiali në sipërmarrjen e përbashkët ose në pjesëmarrje të matur me kosto.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

b) Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kurset e këmbimit në datën e transaksioneve. Aktivet dhe detyrimet jo- monetare të mbajtura në monedhë të huaj në datën e raportimit nuk rivlerësohen në fund viti dhe maten me koston e tyre historike (konvertuar në monedhën funksionale me kursin e asaj date) përveç, aktiveve dhe detyrimeve jo-monetare të matura me vlerën e tregut të cilat konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës kur u përcaktua vlera e tyre e tregut.

Fitimi apo humbja nga kurset e këmbimit, që rezulton nga kryerja e transaksioneve të tilla si dhe nga përkthimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare të mbajtura në monedhë të huaj, njihet në fitim ose humbje, përveç instrumenteve financiare që mbahen me VDFH, të cilat njihen si një komponent i të ardhurës neto nga instrumentet financiare në VDFH.

Kurset kryesore të konvertimit në Lek Shqiptar për 1 njësi të monedhës së huaj në datën e raportimit janë si më poshtë

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
EURO	98.15	103.88
USD	94.26	93.94

c) Klasifikimi i kontratave të sigurimit

Kontratat nën të cilat Shoqëria pranon të marrë një rrezik sigurimi të rëndësishëm nga një palë tjetër (policë-mbajtësi) duke rënë dakord të kompensojë policë-mbajtësin ose përfitues të tjerë për një ngjarje të caktuar të pasigurt (ngjarja sigurorese) e cila ka efekte negative dhe ndikon në policë-mbajtësin apo përfituesit e tjerë, klasifikohet si kontratë sigurimi.

Rreziku i sigurimit është i ndryshëm nga rreziku financiar. Rreziku financiar është rreziku i ndryshimeve të mundshme të ardhshme në një ose më shumë nga norma interesi specifike, çmimet e letrave me vlerë, çmimet e komoditeteve, kursi i këmbimit, indeksat e çmimeve ose të normave, vlerësimi i aftësisë kredituese apo indeksat e kreditimit ose variabla të tjerë, të siguruar në rastin e variablave jo-financiare kur variabli nuk është specifik për një palë në kontratë.

Pasi një kontratë është klasifikuar si një kontratë sigurimi, mbetet një kontratë sigurimi për pjesën e mbetur të jetës së saj, edhe nëse rreziku i sigurimit zvogëlohet ndjeshëm gjatë kësaj periudhe, përveç nëse të gjitha të drejtat dhe detyrimet shuhen ose skadojnë.

d) Njohja dhe matja e kontratave të sigurimit

i. Primet

Primet për sigurimin e jetës - afatshkurtra

Primet e shkruara bruto përfshijnë shumat e përfituara nga polica ose kontrata sigurimi të lidhura gjatë vitit financiar në lidhje me sigurimin e drejtpërdrejtë, pavarësisht nga fakti se shumat të tilla mund të lidhen tërësisht apo pjesërisht me një periudhë të mëvonshme në kontabilitet. Primet paraqiten bruto përfshirë komisionet e ndërmjetësve dhe taksat e bazuara në prime. Pjesa e fituar e primeve të pranuar njihet si e ardhur. Primet janë të fituara nga data e marrjes përsipër të rrezikut, përgjatë periudhës së sigurimit, bazuar në modelin e rrezikut të nënshkruar.

Primet për sigurimin e jetës - afatgjata

Për kontratat e sigurimit që kontrahohen me debitorë të Bankave të nivelit të dytë në Shqipëri, dhe që kanë afat disa vjeçar, për mbulimin e kredisë gjatë afatit të shlyerjes së saj, Shoqëria njihet në të ardhura primin e shkruar bruto vjetor në momentin që lëshon kontratën e sigurimit. Për kontratat afatgjata për të cilat Shoqëria arkëton primin në total për të gjithë afatin e kontratës, pjesa e mbetur e kontratës afatgjatë të sigurimit me debitorët, që nuk është njohur në periudhën raportuese pasqyrohet si angazhim i Shoqërisë për vitet e ardhshme.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

Rezerva për primin e pafituar

Primet e pafituara përfshijnë atë pjesë të primeve të shkruara bruto, me periudhat e rrezikut pas datës së raportimit. Primi i pafituar llogaritet nga prime të shkruara bruto, dhe shtyhet për t'u njohur në periudhat pasardhëse si rezervë për primet e pafituara. Për llogaritjen e rezervës së primit të pafituar janë marrë në konsideratë kontratat e shitura për të gjitha linjat e biznesit të jetës. Në llogaritjen e rezervës së primit të pafituar është përdorur metoda e ditëve ekzakte mbi primin bruto të sigurimit dhe nuk janë konsideruar në llogaritjet për rezervën e primit të pafituar policat e kthyer apo anuluar.

Në lidhje me produktin e Jetës së Debitorit, rezerva e primit është llogaritur me metodat aktuariale për provigjionet, duke marrë në konsideratë shumën e sigurimit të jetës së debitorit si dhe tabelat e mortalitetit për çdo moshë dhe gjini.

Primet e risigurimit

Primet e jashtme të risigurimit njihen si shpenzim në përputhje me modelin e shërbimit të marrë nga risiguruesi. Nëse një policë sigurimi anulohet, primi i mbetur për t'u paguar përfshihet në të ardhurat nga primet. Lëvizja e detyrimeve nga risigurimi, nëse ka ndonjë, njihet si e ardhur neto e pjesës së risiguruesit. Shoqëria ka marrëveshje risigurimi për ekspozimet e sigurimit të Jetës së Debitorit.

Të ardhura nga investimet

Të ardhurat nga interesi për letrat me vlerë dhe depozitat njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes, në masën proporcionale që i takon periudhës raportuese dhe llogariten duke përdorur metodën e Normës Efektive të Interesit (NEI). Tarifat dhe komisionet që janë pjesë përbërëse e yield-it efektiv të aktivitetit financiar njihen si një rregullim në NEI të instrumentit. Shoqëria ka investime në depozita dhe letra me vlerë të investimeve.

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim llogariten në bazë të policave të sigurimit të jetës me kursim, afateve të rregullta dhe afateve të veçanta. Kostot e marrjes në sigurim shtyhen për kohëzgjatjen e policave përkatëse. Shpenzimet e marrjes përcaktohen si kosto që rrjedhin nga blerja e kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë kostot direkte, siç janë komisionet e blerjes dhe koston e hartimit të dokumentit të sigurimit, si dhe shpenzimet administrative të ndara lidhur me përpunimin e propozimeve dhe lëshimin e politikave.

ii. Dëmet

Dëmet që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të jetës

Dëmet përbëhen nga pagesat e bëra gjatë vitit financiar së bashku me ndryshimin në rezervën për dëmet. Dëmet bruto të paguara përfshijnë të gjitha shpenzimet e bëra për këto dëme. Rikuperimet në avancë nga risigurimi paraqiten më vete si aktive.

Rezervat për dëmet

Rezerva për dëmet (RBNS) janë shumat e të gjitha dëmeve që kanë lindur gjatë periudhës financiare aktuale dhe asaj të mëparshme të cilat nuk janë paguar në përfundim të vitit fiskal, mbështetur në vlerën e rezervës të llogaritur nga specialisti i dëmeve. Rezerva përfshin edhe dëmet e ndodhura, por të paraportuara (IBNR) në atë datë, të cilat llogariten duke përdorur metodat e trekëndëshit.

Rezervat matematikore

Rezervat matematikore lidhen me sigurimin e jetës dhe maten me vlerën e plotë të akumuluar në fund të periudhës raportuese, duke përfshirë produktet e sigurimit të jetës.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

d) Njohja dhe matja e kontratave të sigurimit (vazhdim)

Risigurimi

Shoqëria çedon risigurimin në rrjedhën normale të biznesit me qëllim që të limitojë humbjen neto nëpërmjet diversifikimit të rrezikut. Marrëveshjet e risigurimit nuk i heqin Shoqërisë detyrimet ndaj policëmbajtësve. Primet e ceduara dhe përfitimet e rimbursimit paraqiten në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse dhe pasqyrën e pozicionit financiar me baza bruto. Kontratat nga të cilat lind një transferim i rrezikut të sigurimit kontabilizohen si sigurim. Shumat e rigjeneruara nga këto kontrata njihen në të njëjtin vit me dëmin.

Aktivitet e risiguara përfshijnë balanca detyrimi nga shoqëria risiguruese për detyrimet e primeve të ceduara si dhe shuma të rikuperueshme nga dëmet e paguara. Këto shuma, nëse ka të tilla, klasifikohen si shuma të arkëtueshme dhe paraqiten në pasqyrat financiare. Llogaritë e arkëtueshme nga kontratat e risigurimit përfshijnë komisionet e risigurimit nga primet e ceduara të risiguruesit dhe të arkëtueshmet nga shoqëria risiguruese në përputhje me dëmin e paguar. Këto klasifikohen si llogari të arkëtueshme dhe paraqiten të veçanta. Aktivitet e risigurimit vlerësohen për zhvlerësim në çdo datë raportimi. Këto aktive zhvlerësohen nëse ka evidencë objektive, si pasojë e një ngjarje që ka lindur pas njohjes fillestare, për të cilat Shoqëria nuk mund të rimarrë të gjitha shumat që i detyrohen dhe për një ngjarje e cila ka një impakt të matur në mënyrë të besueshme për shumat të cilat Shoqëria do të marrë nga risiguruesi.

iii. Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve

Në çdo datë raportimi Shoqëria bën një test të mjaftueshmërisë së rezervës i cili i jep Shoqërisë një vlerësim nëse detyrimet e sigurimit të cilat janë njohur janë të mjaftueshme. Gjithashtu, testet e kryera përfshijnë Analizën e Raportit të Dëmeve dhe Analizën e Zhvillimit të provigjioneve të dëmeve. Analiza e raportit të dëmeve kryhet çdo vit individualisht për të gjitha produktet kryesore të biznesit. Llogaritja bëhet vetëm mbi dëmet, si dhe mbi dëmet duke përfshirë kostot e blerjes dhe ndonjë kosto tjetër të jashtme si kostoja e mirëmbajtjes.

Për të kryer këtë analizë, Shoqëria merr parasysh parashikimet për daljet e flukseve të parave. Shoqëria nuk i skonton këto flukse parash sepse shumica e dëmeve priten të shlyhen brenda vitit.

Gjithashtu, Shoqëria bën edhe Analizën e Zhvillimit të provigjioneve të dëmeve për të vlerësuar metodologjinë e saj të përcaktimit të rezervave. Kjo analizë kryhet në mënyrë të veçantë, por dhe të kombinuar për RBNS (të raportuara, por ende të pambyllura) dhe IBNR (të ndodhura, por të paraportuara). Nëse analiza nxjerr në pah mospërputhje të mëdha, Shoqëria kryen rregullime në metodologjinë e përdorur. Nëse identifikohet një mungesë ajo ngarkohet menjëherë në fitim ose humbje duke krijuar një provigjion për riskun e pa skaduar nga humbjet që dalin nga testi i mjaftueshmërisë së rezervës.

e) Instrumentet financiare

(i) Njohja

Shoqëria fillimisht njeh llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat në datën kur ato janë krijuar. Të gjitha detyrimet dhe aktivet financiare njihen në datën e transaksionit sipas së cilit Shoqëria bëhet palë e detyrimeve kontraktore të instrumentit.

(iii) Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar nëse humbet kontrollin mbi flukset e ardhshme të parasë ose transferon të drejtat për të marrë flukset kontraktuale të parasë nga aktivet financiare në transaksione në të cilat i gjithë rreziku dhe përfitimet nga aktivet financiare është transferuar. Çdo interes nga aktivi financiar i transferuar që është krijuar ose mbajtur nga Shoqëria njihet si aktiv ose detyrim i veçantë. Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shuhen, anulohen ose maturohen.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

e) Instrumentet financiare (vazhdim)

(iii) Netimi

Aktivet dhe detyrimet financiare mund të netohen dhe tepricat neto të paraqiten në bilanc vetëm kur Shoqëria ka të drejta ligjore për të netuar shumat dhe ka qëllim të arkëtojë ose të mbylli aktivin apo detyrimin neto në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten të netuara kur lejohet nga Standardet e Kontabilitetit, ose për fitime dhe humbje që lindin nga transaksione me natyrë të njëjtë përgjatë aktivitetit të Shoqërisë.

(iv) Matja me kosto të amortizuar

Kosto e amortizuar e një aktivi financiar është vlera me të cilën aktivi financiar ose detyrimi financiar është matur në njohjen fillestare, duke zbritur kështu e paguara, plus ose minus amortizimin kumulativ që rezulton nga përdorimi i metodës së interesit efektiv duke marrë parasysh ndonjë diferencë midis vlerës së njohur në fillim dhe vlerës në maturim si dhe humbjet nga rënia në vlerë.

(v) Matja me vlerë të drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është bazuar në çmimet e publikuara të tregut dhe treguesve të instrumenteve financiare në tregjet aktive. Për të gjitha instrumentet financiare të tjera vlera e drejtë është përcaktuar duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknika të tilla si vlera reale neto, metoda e aktualizimit të flukseve, krahasimi me instrumente të tjerë të ngjashëm për të cilat çmimet përcaktohen në tregje aktive, si dhe modele të tjera vlerësimi.

(vi) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë

Në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare Shoqëria vlerëson nëse ka evidenca objektive për rënien në vlerë të aktiveve financiare. Aktivet financiare pësojnë rënie në vlerë kur evidenca objektive dëshmon që një ngjarje me pasojë humbje ka ndodhur pas vlerësimit të mëparshëm të aktivit, si dhe kjo ngjarje ndikon në flukset e mjeteve monetare të vlerësueshme në mënyrë të besueshme.

Shoqëria merr në konsideratë evidenca për rënien në vlerë të aktiveve financiare specifike ose në grup të aktiveve. Të gjitha aktivet individualisht të rëndësishme testohen veçmas për humbjen e mundshme në vlerë, por që nuk është identifikuar ende. Të gjitha aktivet që nuk konsiderohen të jenë individualisht të rëndësishëm grupohen dhe vlerësohen së bashku me aktive me karakteristika të ngjashme (të mbajtura me kosto të amortizuar) për rënie në vlerë.

Si evidencë objektive për rënie në vlerë të mundshme të aktiveve në pasqyrat financiare mund të përmendet mosshlyerja në kohë apo shkelja e termave nga një debitor, ristrukturimi i një kredie/paradhënie të dhënë nga Shoqëria me terma të cilat në kushte të tjera nuk do të ishin konsideruar, tregues për falimentimin e mundshëm të një debitori ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si ndryshimi në përkeqësim në statusin e arkëtueshmërisë së një debitori ose kreditori, apo kushte ekonomike që ndikojnë në përkeqësim të grupit të aktiveve.

f) Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to përfshijnë balancat e gjendjes në arkë, mjetet monetare të depozituara në banka të nivelit të dytë dhe investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe me maturitet deri në tre muaj ose më pak që nga momenti i blerjes.

g) Depozitat me afat

Depozitat me afat paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar me shumën e principalit të tyre dhe klasifikohen sipas maturitetit. Depozitat me afat me maturitet më të vogël se tre muaj klasifikohen si ekuivalentë të mjeteve monetare, ato me maturitet midis tre dhe dymbëdhjetë muaj klasifikohen si investime në depozita me afat.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

h) Investimet në Letra me Vlerë

Letrat me vlerë janë investime borxhi të cilat Shoqëria ka për qëllim dhe aftësi t'i mbajë deri në maturim dhe që janë klasifikuar si aktive të mbajtura deri në maturim. Investimet të cilat kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe të cilat synohen të mbahen deri në maturim dhe si rrjedhim maten me kosto të amortizuara, minus provigjionin për rënien në vlerë. Kosto e amortizimit llogaritet duke marrë në konsideratë ndonjë skontim ose prim në blerje. Primet dhe skontimet në investimet e projektuara si të mbajtura deri në maturim amortizohen sistematikisht gjatë maturitetit duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe regjistrohen si të ardhura nga interesi.

i) Llogaritë e arkëtueshme sigurimi dhe të tjera

Kreditë dhe të drejtat e tjera njihen në fillim me vlerë të drejtë dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus provigjionin për zhvlerësim. Provigjioni për zhvlerësimin e kredive dhe të drejtave të tjera të arkëtueshme krijohet kur ka një evidencë objektive që shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve fillestare. Të drejtat e arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit që vijnë nga mbajtësit e policave të sigurimit gjithashtu klasifikohen në këtë kategori dhe rishikohen për zhvlerësim si pjesë e rishikimit për zhvlerësim të kredive dhe të drejtave të tjera të arkëtueshme.

j) Njohja e të ardhurave

i. Prime të shkruara bruto

Primet e shkruara bruto janë njohur siç shpjegohet në Shënimin 3.d.

ii. Të ardhura nga interesi

Të ardhurat nga interesi për aktivet financiare është njohur duke përdorur metodën e interesit efektiv.

k) Shpenzimet për personelin

Shoqëria paguan vetëm kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat u sigurojnë punonjësve përfitime pensioni pas shkëputjes nga puna. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për të përcaktuar kufirin e vendosur minimal për pensionet në vendet përkatëse sipas një plani të përcaktuar kontributesh pensioni. Kontributet e Shoqërisë për planin e pensionit paraqiten në pasqyrën përmbledhëse individuale të të ardhurave kur ndodhin.

Leja vjetore e paguar

Shoqëria njih si detyrim shumë të pa skontuar të kostove të parashikuara në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në shkëmbim të shërbimeve të punonjësve për periudhën e përfunduar. Për vitin 2024 punonjësit e shoqërisë i kanë përfunduar lejet e tyre vjetore.

l) Shpenzimet administrative

Shpenzimet administrative njihen kur ato ndodhin.

m) Detyrime të tjera

Detyrime të tjera njihen me koston e tyre.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

n) Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje tjetër nga zhvlerësimi përveç ndërtimeve në proces të cilat maten me vlerën e rivlerësuar. Kostoja historike përfshin shpenzime që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me blerjen e këtyre elementeve. Kur pjesë të një aktivi kanë diferenca mbi jetëgjatësinë e dobishmërinë, ato njihen si aktive të ndara (komponentë të rëndësishëm) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitja përcaktohen duke krahasuar shumat e marra me vlerën e mbetur, dhe duke përfshirë diferencën në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave në zërin 'Fitime/(humbje) të tjera'.

Kostot e mëpasshme

Kostot e mëpasshme përfshirën në vlerën e aktivit ose njihen si një aktiv i veçantë vetëm kur është e mundshme që përfitimet të ardhshme do të rrjedhin nga ky aktiv dhe kostoja mund të matet në mënyrë të besueshme. Vlera kontabël e pjesës së zëvendësuar nuk njihet. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtja i ngarkohen fitimit dhe humbjes së periudhës financiare në të cilën ato kryhen.

Amortizimi

Amortizimi i kategorisë së ndërtësive dhe përmirësimeve në infrastrukturë bëhet në vijë të drejtë mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktiveve, ndërsa amortizimi i njësive të tjera të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2024 llogaritet duke përdorur metodën lineare (31 dhjetor 2023: metodën e amortizimit zbritës të llogaritur mbi vlerën e mbetur të aktivit). Toka dhe aktivet nën ndërtim nuk amortizohen. Normat e vlerësuara të zhvlerësimit janë si më poshtë:

Ndërtesa (Kioska)	5 %
Mobilie dhe pajisje zyrash	20 %
Kompjuterët dhe pajisje IT	25 %
Aktive të patrupëzuara	25%
Mjete transporti	20 %
Përmirësime në ambientet e marra me qira	(sipas afatit të kontratës së qirasë)

o) Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivitet jo-materiale të shoqërisë të ndryshme nga emri i mirë kanë jetë të dobishme të caktuar dhe kryesisht përfshijnë programe kompjuterike të kapitalizuara, patenta, marka tregtare dhe licencat. Licencat e programeve kompjuterike, patentat dhe markat tregtare kapitalizohen në bazë të shpenzimeve të bëra për t'i marrë dhe vënë në përdorim. Kostot e zhvillimit që lidhen direkt me programe të identifikueshme dhe unike që kontrollohen nga Shoqëria regjistrohen si aktive jo-materiale nëse rrjedhja e përfitimeve ekonomike në rritje i tejkalon kostot.

Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave bazuar në vlerën e mbetur duke përdorur normat fiskale për amortizimin e aktiveve të patrupëzuara, një muaj pas blerjes së aktivit. Jeta e dobishme e aktiveve rishikohet, dhe bëhen rregullimet e nevojshme, në çdo datë bilanci. Norma e amortizimit është 15% bazuar në vlerën e mbetur të aktivit.

Fitimet dhe humbjet nga shitja përcaktohen duke krahasuar shitjet me vlerën e mbetur dhe diferencat përfshihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

p) Zhvlerësimi

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë shqyrtohet në çdo datë bilanci për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë tregues për rënie në vlerë. Në qoftë se ekziston ndonjë tregues i tillë, drejtimi vlerëson vlerën e rikuperueshme, e cila përcaktohet si vlera më e lartë e një aktivi me vlerën e drejtë minus kostot për shitje dhe vlerën e saj në përdorim. Vlera kontabël është zvogëluar në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin.

Një humbje nga zhvlerësimi e njohur për një aktiv në vitet e mëparshme kthehet kur është e përshtatshme nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e aktivit në përdorim ose vlerën e drejtë minus kostot për shitje.

q) Shpenzimet e marrjes në sigurim

Shpenzimet e marrjes në sigurim përcaktohen si kosto që rrjedhin nga blerja e kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë edhe kostot direkte, të tilla si komisionet e blerjes dhe kostot e krijimit të dokumentit të sigurimit dhe pjesën e shpenzimeve administrative që lidhen me procesin e propozimit dhe emetimit të policave. Shpenzimet e marrjes në sigurim njihen si shpenzime kur lindin.

r) Kapitali

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kapitali i Shoqërisë mbahet me vlerën ekuivalent në Lek të kontributit të marre në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Kapitali i nënshkruar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale të tij.

s) Provigjionet

Një provigjion njihet kur Shoqëria ka një detyrim aktual ose konstruktiv si rezultat i një ngjarjeje të shkuar dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provigjionet përcaktohen duke zbritur flukset e ardhshme të parave të gatshme në normën para tatimit. Dispozitat pasqyrojnë vlerësimet aktuale të tregut për vlerën kohore të parasë dhe, kur është e përshtatshme, rreziqet specifike për detyrimin.

t) Tatimi

Tatimi mbi fitimin është njohur në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe paraqet shumën e tatimit aktual dhe të shtyre.

(i) Tatim fitimi aktual

Tatimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, i cili llogaritet duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit dhe ndonjë rregullim të tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Fitimi fiskal ndryshon nga fitimi neto i raportuar në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave dhe shpenzimeve sepse përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në vitet e tjera dhe gjithashtu përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve që nuk janë asnjëherë të tatueshme ose të zbritshme.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë kontabilizohet duke përdorur metodën e detyrimeve të bilancit kontabël dhe llogaritet si tatimi i pritshëm për tu paguar ose për tu arkëtuar nga diferencat e përkohshme midis vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime fiskale. Shuma e tatimit të shtyrë të lejuar bazohet në mënyrën e parashikuar të realizimit ose pagesës të shumave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve, duke përdorur normat fiskale të miratuara ose që priten të miratohen me siguri në datën e raportimit.

(iii) Detyrimet e shtyra tatimore

Detyrimet e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme dhe aktivet tatimore të shtyra njihen vetëm nëse është e mundur që në të ardhmen do të ketë përfitime fiskale kundrejt të cilave do të mund të shfrytëzohen diferencat e përkohshme. Aktivet tatimore të shtyra reduktohen kur nuk ka mundësi që përfitimet e lidhura tatimore do të realizohen. Tatimi i shtyrë llogaritet me normën e taksës që është parashikuar për tu zbatuar në periudhën kur detyrimi paguhet ose aktivi të realizohet dhe ngarkohet në pasqyrën përmbledhëse të konsoliduar të të ardhurave, përveç kur është e lidhur me zërat e ngarkuar direkt në kapital. Në të tilla raste tatimi i shtyrë është gjithashtu pjesë e kapitalit.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

u) Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarë dhe drejtorët e shoqërisë, së bashku me entitete që ata kontrollojnë, të cilët mund të ushtrojnë influencë të konsiderueshme në operacionet dhe menaxhimin e shoqërisë. Duke konsideruar çdo palë të mundshme të tretë vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm forma ligjore.

v) Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së bilancit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e shoqërisë në datën e pasqyrës së pozicionit financiar (veprimet rregulluese), janë të reflektuara në pasqyrat financiare të konsoliduara. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime rregulluese janë pasqyruar në shënimet shpjeguese kur janë materiale.

w) Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shënimet shpjeguese nëse mundësia e konsumimit të burimeve që kanë përfitime ekonomike është e ulët. Aktivët e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënimet sqaruese kur mundësia e të ardhurave ekonomike është e mundshme.

Shuma e humbjes së kushtëzuar njihet si provigjion nëse është e mundshme që ngjarje të ardhshme do të konfirmojnë provigjionin, një detyrim njihet në ditën e pasqyrës së pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet në mënyrë të besueshme.

x) SNRF 16 Qiratë

SNRF 16, Qiratë është efektive për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janar 2019. SNRF 16 sjell një model të vetëm kontabël të paraqitjes në bilanc të qirave nga qiramarrësit. Një qiramarrës njihet një aktiv për të drejtën e përdorimit që përfaqëson të drejtën e tij të përdorimit të aktivitetit bazë dhe një detyrim qiraje që përfaqëson detyrimin e tij për të bërë pagesa qiraje. Ka përjashtime nga njohja për qiratë afatshkurtra dhe qiratë të aktiveve me vlerë të ulët. Kontabiliteti për qiradhënësin do të mbetet kryesisht i pandryshuar dhe do të ruhet dallimi ndërmjet qirasë operative dhe financiare.

4. VLERËSIMET DHE GJYKIMET KONTABËL

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet e ndërlidhura bazohen në përvojën historike dhe në faktorë të tjerë që besohet të jenë të arsyeshëm sipas rrethanave dhe informacioneve në dispozicion në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare, rezultatet e të cilave formojnë bazën për të bërë gjykime mbi kryerjen e vlerat e akëtëve dhe pasiveve që nuk janë të dukshme nga burime të tjera. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimi i vlerësimeve kontabël njihet në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet nëse ndryshimi ndikon vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme nëse ndryshimi ndikon në periudhat aktuale dhe në të ardhmen.

Gjykimet e bëra nga drejtimi në zbatimin e SNRF-ve që kanë efekt të rëndësishëm në pasqyrat financiare dhe vlerësimet me një rrezik të konsiderueshëm të përshtatjes materiale në vitin e ardhshëm janë diskutuar më poshtë.

4. Vlerësimet dhe gjykimet kontabël (vazhdim)

Humbja nga zhvlerësimi i të arkëtueshmeve

Shoqëria rishikon llogaritë e arkëtueshme të sigurimit dhe të tjera për të vlerësuar zhvlerësimin në baza vjetore. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në fitim ose humbje, shoqëria bën gjykime nëse ka ndonjë të dhënë të dukshme që tregojnë se ka një rënie të matshme në flukset e ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare nga një grup llogarish të arkëtueshme para rënies që mund të jetë identifikuar me një debitor individual në atë portofol. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të debitorit që lidhen me mungesat në aktivet në grup. Menaxhimi i shfrytëzon vlerësimet bazuar në përvojën historike të humbjeve për aktivet me karakteristika të rrezikut të kredisë dhe evidenca objektive të zhvlerësimit të ngjashme me ato në portofol kur cakton flukset e ardhshme të parasë.

Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimin e vijimësisë

Në datën e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara, Shoqëria po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara.

5. MENAXHIMI I RREZIQEVE

a) Rreziku i sigurimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut aktuarial dhe marrjes në sigurim që rrjedhin nga një gamë e gjerë të produkteve të jetës të ofruara për konsumatorët. Rreziku i sigurimit ka të bëjë me pasigurinë e biznesit të sigurimit. Komponentët më të rëndësishëm të rrezikut të sigurimit janë rreziku i primit dhe rreziku i rezervës. Kjo ka të bëjë me shqetësimin në lidhje me përshtatshmërinë e nivelit të normës së primit të sigurimit dhe mjaftueshmërinë e provizioneve për detyrimet e sigurimit dhe baza e kapitalit.

Rreziku i primit është i pranishëm sapo është lëshuar polica e sigurimit, dhe është rreziku që shpenzimet dhe humbjet e shkaktuara të jenë më të larta se primi i marrë. Rreziku rezervës paraqet rrezikun që niveli absolut i rezervave teknike është i nënvlerësuar ose që pretendimet faktike do të luhaten rreth vlerës statistikore të përlllogaritur.

Komponentët e rrezikut të marrjes në sigurim të biznesit të jetës përfshijnë edhe rrezikun biometrik (duke përfshirë vdekshmërinë, jetëgjatësinë, sëmundshmërinë dhe paaftësinë) dhe rrezikun e gabimit. Rreziku i gabimit lidhet me normën më të lartë të paparashikuar ose normën më të ulët të gabimeve të politikave, anulimeve, ndryshimet në statusin e pagesës (ndërprerjen e pagesës së primit) dhe të ndërprerjeve.

Risigurimi blihet nga Shoqëria për të ulur rrezikun potencial nga humbjet si pasojë e ngjarjeve të mëdha individuale ose katastrofa dhe gjithashtu për të patur akses nga specialistë të rreziqeve dhe asistencë në administrimi e kapitalit. Policat e risigurimit nënshkruhen me risigurues të aprovuar në bazë proporcionale ose në bazë të marrëveshjeve për humbjen.

Ngjarjet e sigurimit janë të rastësishme dhe numri aktual i dëmeve dhe përfitimeve mund të ndryshojë nga viti në vit nga niveli i caktuar nga teknikat statistikore. Eksperienca tregon se sa më i madh të jetë portofoli i kontratave të njëjta të sigurimit aq më e vogël do të jetë varianca relative e rezultateve. Gjithashtu, një portofol i diversifikuar më shumë ka më pak mundësi që të ndikohet nga ndryshimet në portofol.

Risigurimi përdoret për të administruar rrezikun e sigurimit. Megjithatë kjo nuk heq përgjegjësinë e Shoqërisë si siguruesi kryesor. Nëse risiguruesi nuk paguan një dëm për arsye të ndryshme, Shoqëria është e detyruar që të paguajë policëmbajtësin për detyrimin. Aftësia paguese e risiguruesit analizohet çdo vit duke rishikuar pozicionin e tyre financiar përpara së të nënshkruajnë kontratën. Shoqëria ka ceduar rrezikun e sigurimit për të limituar ekspozimin nga humbjet nga kontratat e nënshkruara dhe të minimizojë efektin e humbjes nga sigurimi i jetës, duke nënshkruar kontrata risigurimi.

5. Menaxhimi i rreziqeve (vazhdim)

b) Rreziku i risigurimit

Shoqëria cedon rrezikun e sigurimit që të limitojë ekspozimin e humbjeve nën marrëveshje të ndara për çdo lloj sigurimi. Këto marrëveshje risigurimi e shpërndajnë rrezikun dhe minimizojnë efektin e humbjes. Shuma e secilit rrezik të mbetur varet nga vlerësimi që Shoqëria i bën rreziqeve specifike, i cili është subjekt në disa rrethana, i limiteve maksimale bazuar në karakteristikat e mbulimit. Nën termat e marrëveshjes së risigurimit, risiguruesi bie dakord që të rimbursojë shumën e ceduar në rastin e dëmeve të paguara.

Megjithatë, Shoqëria mbetet e detyruar ndaj policëmbajtësve të saj në lidhje me sigurimin e ceduar nëse risiguruesi nuk përmbush detyrimet e tij.

Përqendrimi i provigjioneve teknike dhe të dëmeve sipas llojit është përmbledhur në tabelën e mëposhtme

c) Rreziku i normave të interesit

Rreziku i normave të interesit është i ndikuar nga rreziku i luhatjeve të vlerave të instrumenteve financiare si pasojë e ndryshimeve në tregun e normave të interesit dhe rreziku që maturitetet e interesave në lidhje me aktivet të ndryshojë nga maturiteti i interesave të lidhura me detyrimet e përdorura për këto aktive. Kohëzgjatja për të cilën është fiksuar norma e interesit mbi një instrument financiar tregon se ndaj çfarë niveli rreziku të normave të interesit është ekspozuar. Aktivet dhe pasivet e shoqërisë kanë norma interesi të tregut.

Shoqëria mban një shumë jo të konsiderueshme të detyrimeve interes mbartëse dhe rreziku i shkakimit të kostove të rëndësishme që vijnë si shkak i rritjes në normat e interesit nuk është domethënës. Në krahun tjetër, aktivet interes mbartëse kanë normë interesi fikse.

d) Rreziku i administrimit të kapitalit

Struktura kapitale e shoqërisë konsiston në kapitalin aksionar të shoqërisë që përbëhet nga kapitali themeltar, rezervat dhe fitimet e mbartura. Objektivat kryesore të Shoqërisë për administrimin e kapitalit janë:

- Të jetë në përputhje me kërkesat nga entet rregullatore Shqiptare për tregun e sigurimit duke mbajtur kapital mbi limitin e kërkuar;
- Të sigurojë mundësinë e vijimësisë së aktivitetit të Shoqërisë në mënyrë që ajo të mund të gjenerojë fitime për aksionarët dhe përfitime për grupet e interesit të tjera.

Në përputhje me ligjin shqiptar Nr. 52/2014 "Për sigurime dhe risigurime", datë 4 korrik 2014, Shoqëria e sigurimit është e detyruar të përmbush kërkesat e nenit 80 dhe 81. Sipas këtyre kërkesave, kapitali i përgjithshëm i Shoqërisë duhet të jetë së paku shuma e aftësisë paguese të llogaritur (dmth më e lartë e fondit të garancisë dhe 150% e aftësisë paguese të llogaritur në bazë të të njëjtit ligj). Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të Shoqërisë është 122.3% në 2023 (2022: 116.6%). Shoqëria menaxhon kapitalin për të siguruar nivelin e duhur të kapitalit në mënyrë që të jetë e aftë të vazhdojë në vijimësi dhe të përmbushë kërkesat rregullatore të kapitalit, ndërkohë që maksimizon kthimin tek aksionaret nëpërmjet optimizmit të gjendjes së detyrimeve dhe kapitalit.

e) Rreziku nga kurset e këmbimit

Primet janë shprehur në tre valuta kryesore (Lek, USD dhe Euro). Tabela e mëposhtme paraqet një analizë sasiore të rrezikut valutor të shoqërisë më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 për luhatje të mundshme në kurset e këmbimit.

	Ndikimi	2024 në Lek	2023 në Lek
EUR rritet me 10% ndaj Lekut	Fitim	9,169,400	7,886,541
EUR ulet me 10% ndaj Lekut	Humbje	(9,169,400)	(7,886,541)
USD rritet me 10% ndaj Lekut	Fitim	1,932,187	1,908,060
USD ulet me 10% ndaj Lekut	Humbje	(1,932,187)	(1,908,060)

5. Menaxhimi i rreziqeve (vazhdim)

e) Rreziku nga kurset e këmbimit (vazhdim)

Tabela e mëposhtme paraqet një analizë sasiore të rrezikut valutor të Shoqërisë më 31 dhjetor 2024:

Aktive Financiare	LEK	EUR	USD	Totali
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	11,913,546	11,889,973	123,180	23,926,699
Depozita me afat me bankat	262,423,896	226,270,957	19,187,721	507,882,574
Investime në letra me vlerë	174,093,884	-	-	174,093,884
Llogari të arkëtueshme sigurimi, neto	36,807,663	6,318,267	15,100	43,141,030
Aktive të tjera	11,428,470	2,491,515	-	13,919,985
Totali i aktiveve financiare	496,667,459	246,970,712	19,326,001	762,964,172
Detyrime Financiare	LEK	EUR	USD	Totali
Rezerva për humbjen dhe rregullimi i shpenzimeve të humbjes	17,669,578	18,407,629	-	36,077,207
Rezerva matematikore	-	121,754,403	-	121,754,403
Llogari të pagueshme për sigurimet dhe risigurimet	11,987,101	6,285,382	-	18,272,483
Detyrimi për tatim fitimin	-	-	-	-
Detyrime nga institucionet financiare	-	4,934,826	-	4,934,826
Detyrime të tjera	28,760,125	3,894,473	4,127	32,658,725
Totali i detyrimeve financiare	58,416,804	155,276,713	4,127	213,697,644
Pozicioni valutor, neto	438,250,655	91,693,999	19,321,874	549,266,528

Tabela e mëposhtme paraqet një analizë sasiore të rrezikut valutor të Shoqërisë më 31 dhjetor 2023:

Aktive Financiare	LEK	EUR	USD	Totali
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	8,622,932	12,121,153	66,530	20,810,615
Depozita me afat me bankat	262,319,361	190,543,586	19,097,718	471,960,665
Investime në letra me vlerë	175,950,987	-	-	175,950,987
Llogari të arkëtueshme sigurimi, neto	38,460,603	5,111,123	6,689	43,578,415
Aktive të tjera	6,849,244	2,447,369	-	9,296,613
Totali i aktiveve financiare	492,203,127	210,223,231	19,170,937	721,597,295

Detyrime Financiare	LEK	EUR	USD	Totali
Rezerva për humbjen dhe rregullimi i shpenzimeve të humbjes	12,770,934	15,726,268	-	28,497,202
Rezerva matematikore	-	98,298,989	-	98,298,989
Llogari të pagueshme për sigurimet dhe risigurimet	12,841,977	7,550,095	-	20,392,072
Detyrimi për tatim fitimin	3,424,900	-	-	3,424,900
Detyrime nga institucionet financiare	-	6,926,825	-	6,926,825
Detyrime të tjera	9,817,210	2,855,639	90,334	12,763,183
Totali i detyrimeve financiare	38,855,021	131,357,816	90,334	170,303,171
Pozicioni valutor, neto	453,348,106	78,865,415	19,080,603	551,294,124

f) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është i pranishëm në biznesin e Shoqërisë pasi aktivet e blera dhe detyrimet e shitura kanë karakteristika likuiditeti specifike. Por nëse Shoqërisë do t'i nevojiteshin likuiditete të mëdha brenda një kohe të shkurtër, nuk do të ishte e vështirë për sigurimin e tyre nisur nga mënyra e organizimit të investimit në periudha maturimi të diversifikuara, bazuar në këtë analizë menaxhimi beson se nuk do të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve financiare.

Gjithashtu Shoqëria e monitoron gjendjen e saj të likuiditetit çdo ditë, për të përmbushur detyrimet në kohën e duhur.

5. Menaxhimi i rreziqeve (vazhdim)
f) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 dhjetor 2024 është si më poshtë:

SiCRED sh.a. Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 (Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)							
31 dhjetor 2024	Më pak se 1 muaj	1 - 3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	1 - 5 vite	Më shumë se 5 vite	Totali	
Aktive							
Mijete monetare dhe ekuivalente me to	23,926,701	-	-	-	-		23,926,701
Depozita me afat me bankat	114,758,314	39,722,500	186,457,792	29,927,412	137,016,556		507,882,574
Investime në letra me vlerë	45,700,000	-	14,393,884	65,000,000	49,000,000		174,093,884
Llogari të arkëtueshme sigurimi dhe risigurimi, neto	40,154,278	1,414,285	1,572,467	-	-		43,141,030
Aktive të tjera	11,033,141	273,024	2,164,725	449,096	-		13,919,985
Totali i aktiveve	235,572,434	41,409,808	204,588,868	95,376,508	186,016,556		762,964,174
Detyrimet							
Rezerva për humbjen dhe rregullimi i shpenzimeve të humbjes	1,168,635	653,658	20,007,786	-	14,247,129		36,077,208
Rezerva matematikore	5,517,314	-	6,038,769	27,368,862	82,829,458		121,754,403
Llogari të pagueshme për sigurimet dhe risigurimet	18,272,483	-	-	-	-		18,272,483
Detyrimi për tatim fitimin	-	-	-	-	-		-
Detyrime nga institucionet financiare	263,400	358,369	1,612,662	2,700,395	-		4,934,826
Detyrime të tjera	10,356,599	273,542	20,527,831	1,500,753	-		32,658,725
Totali i detyrimeve	35,578,431	1,285,570	48,187,048	31,570,009	97,076,586		213,697,645
Hendeku i maturitetit	199,994,003	40,124,239	156,401,820	63,806,498	88,939,970		549,266,529

5. Administrimi i rreziqeve (vazhdim)
f. Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 dhjetor 2023 është si më poshtë:

31 dhjetor 2023	Më pak se 1 muaj	1 - 3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	1 - 5 vite	Më shumë se 5 vite	Totali
Aktive						
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	20,810,615	-	-	-	-	20,810,615
Depozita me afat me bankat	118,652,606	30,388,000	129,691,699	95,371,927	97,856,433	471,960,665
Investime në letra me vlerë	45,000,000	-	16,950,987	65,000,000	49,000,000	175,950,987
Llogari të arkëtueshme sigurimi dhe risigurimi, neto	22,609,157	5,549,471	15,419,787	-	-	43,578,415
Aktive të tjera	7,611,339	116,666	1,435,268	133,340	-	9,296,613
Totali i aktiveve	214,683,717	36,054,137	163,497,741	160,505,267	146,856,433	721,597,295
Detyrimet						
Rezerva për humbjen dhe rregullimi i shpenzimeve të humbjes	529,810	223,209	13,013,923	-	14,730,260	28,497,202
Rezerva matematikore	8,807,241	-	5,132,665	27,781,927	56,577,156	98,298,989
Llogari të pagueshme për sigurimet dhe risigurimet	12,692,243	2,370,484	5,329,345	-	-	20,392,072
Detyrimi për tatim fitimin	-	3,424,900	-	-	-	3,424,900
Detyrime nga institucionet financiare	188,537	358,369	1,612,662	4,767,257	-	6,926,825
Detyrime të tjera	6,714,098	273,542	4,518,595	1,256,948	-	12,763,183
Totali i detyrimeve	28,931,929	6,650,504	29,607,190	33,806,132	71,307,416	170,303,171
Hendeku i maturitetit	185,751,788	29,403,633	133,890,551	126,699,135	75,549,017	551,294,124

Shoqëria administron ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kredisë në mënyrë sistematike duke monitoruar llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi. Ajo ka krijuar një rregull të brendshëm ku të gjitha policat e papaguara sipas kushteve të kontratave përkatëse anulohen, përveç rasteve ku ka siguri që shuma e arkëtueshme do të mblihet.

Shoqëria administron ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kredisë duke monitoruar zbulimin ndaj depozitave dhe llogarive të tjera të arkëtueshme.

Shoqëria nuk ka identifikuar të dhëna objektive për zhvlerësim e mjeteve të tjera financiare në datën e raportimit, prandaj drejtimi i konsideron aktivet e tjera financiare si ekuivalente të mjeteve monetare, depozitat me afat dhe pasuritë e tjera si as të kaluara e as e zhvlerësuar.

5. Administrimi i rreziqeve (vazhdim)

f. Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Llogari të arkëtueshme sigurimi dhe risigurimi, neto me 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 sipas ditëve në vonesë janë si vijon:

	31 dhjetor 2023		31 dhjetor 2022	
	Lekë	%	Lekë	%
1 - 90 ditë	40,154,278	93.08%	42,555,634	97.65%
91 - 365 ditë	1,414,285	3.28%	1,022,781	2.35%
> 365 ditë	1,572,467	3.64%	-	0.00%
Totali	43,141,030	100%	43,578,415	100%

6. MJETE MONETARE DHE EKUVALENTË ME TO

Mjete monetare dhe ekuivalentë me to më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 përfshijnë llogari rrjedhëse me bankat dhe janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Mjete monetare në arkë	34,605	59,018
Mjete monetare në bankë	23,776,991	20,751,597
Mjete monetare në bankë në monedhë të huaj	11,978,549	12,179,232
Mjete monetare në bankë në monedhë vendase	11,798,442	8,572,365
Mjete monetare në arke dhe banke	23,811,597	20,810,615

7. MJETE MONETARE TË KUSHTËZUARA

Mjete monetare të kushtëzuara më 31 dhjetor 2024 në vlerën 115,105 Leke (2023: 100,000 Leke) lidhet me kapitalin e regjistruar të Shoqërisë SiCRED Assistance.

8. DEPOZITA ME AFAT ME BANKAT

Depozitat me bankat më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 janë të detajuara si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Depozita për fondin e garancisë	314,019,500	316,534,000
Llogari kursimi	180,849,401	139,641,870
Depozita të tjera	7,148,549	7,148,310
Interesi i përllogaritur	5,865,124	8,636,485
Depozita me afat me bankat	507,882,574	471,960,665

Në përputhje me nenin 81 të Ligjit Nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit”, lidhur me fondin e garancisë, Shoqëria mban të bllokuar për fondin e garancisë jo më pak se një të tretën e kufirit minimal të aftësisë paguese të përcaktuar ose 370,000 mijë Lek, cilado që është më e lartë. Fondi i garancisë duhet mbajtur në bono thesari dhe/ose depozita me afat jo më pak se një vit, të bllokuara për fond garancie. Depozita qëllimore janë depozita afatgjatë që lidhen me investimin e primeve të produkteve të sigurimit me elementë kursimi “Sigurimi i Jetës me Kursim” dhe Sigurimi i Jetës me Mbijetesë”.

8. Depozita me afat me bankat (vazhdim)

Depozita të tjera lidhet me depozita të lira me afat 5 vjeçar dhe konsiderohet garanci bankare për llogari overdrafti. Depozita të tjera përbëhen nga dy depozita me kohëzgjatje 3 vjeçare të vendosura si garanci bankare si vijon:

- 2,558,549 Lek për llogari overdrafti, dhe
- 4,590,000 Lek për sigurimin e punonjësve të Bankës së Shqipërisë për kontratën e sigurimit të jetës, që do të lirohet 30 ditë pas datës së përfundimit të afatit të kontratës së sigurimit që është 14 Maj 2025.

9. INVESTIME NË LETRA ME VLERË

Gjate vitit 2024 dhe 2023 Grupi nuk ka ndryshuar politiken për investimet në letrat me vlerë, në Bono Thesari dhe Obligacione, të cilat janë detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Bono Thesari (Fond Garancie)	57,700,000	58,000,000
Skonto për tu amortizuar	(362,746)	(424,624)
Bono thesari, neto	57,337,254	57,575,376
Obligacione	114,000,000	114,000,000
Interesi i llogaritur	2,756,630	4,375,611
Obligacione, neto	116,756,630	118,375,611
Investime në letra me vlerë	174,093,884	175,950,987

Tabela e mëposhtme paraqet normat e interesit maksimale dhe minimale që janë aplikuar për letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim përgjatë vitit 2024 dhe 2023 sipas maturitetit.

	31 dhjetor 2024		31 dhjetor 2023	
Maturiteti	Norma e interesit minimale	Norma e interesit maksimale	Norma e interesit minimale	Norma e interesit maksimale
Bono thesari (Lek)				
12 mujore	2.85%	3.45%	3.10%	4.90%
Letra me vlerë të Qeverisë (Lek)				
5 vjet	3.70%	5.21%	3.70%	3.70%
7 vjet	4.08%	6.00%	4.08%	5.45%
10 vjet	6.25%	7.90%	6.25%	7.90%
15 vjet	8.39%	8.39%	8.39%	8.39%

10. LLOGARI TË ARKËTUESHME SIGURIMI DHE RISIGURIMI, NETO

Llogari të arkëtueshme sigurimi dhe risigurimi, neto përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Debitor Jetë dhe aksidente në Grup	28,082,791	20,576,942
Debitor Cash Plan	2,829,119	14,767,070
Debitor Jeta për hua	9,022,955	4,226,693
Debitor Jetë dhe shëndeti në udhëtim	374,835	424,921
Debitor Jetë me mbijetesë	1,942,456	2,282,415
Debitor Jetë student	1,529,000	1,529,000
Të arkëtueshme nga sigurimi, bruto	43,781,156	43,807,041
Provizjione për klientë të paarkëtuar	(640,126)	(228,626)
Të arkëtueshme nga sigurimi, neto	43,141,030	43,578,415

Lëvizjet në zhvlerësimin e të arkëtueshmeve nga sigurimi dhe risigurimi paraqiten më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Gjendja në fillim të vitit	228,626	852,980
Shtesa / (Rimarrje)	411,500	(624,354)
Gjendja në fund të vitit	640,126	228,626

11. AKTIVE TË RISIGURIMIT

Lëvizjet në aktive të risigurimit më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Rezerva për primin e pafituar në fillim të vitit	14,309,331	10,946,800
Ndryshimi për vitin	2,387,394	3,362,531
Rezerva për primin e pafituar në fund të vitit	16,696,725	14,309,331
Rezerva për dëmet në fillim të vitit	5,194,000	-
Ndryshimi për vitin	(286,500)	5,194,000
Rezerva për dëmet në fund të vitit	4,907,500	5,194,000
Total aktive të risigurimit	21,604,225	19,503,331

Shoqëria cedon primet e sigurimit dhe rrezikun në aktivitetin normal të biznesit për sigurimin e jetës në mënyrë që të kufizojë potencialin e humbjeve që lindin nga ekspozime më të gjata dhe më të ashpra të dëmeve. Këto risigurime përfshijnë bazat e marrëveshjeve, tejkalimin e humbjeve dhe pjesë të aksioneve. Shoqëria cedon sigurim ndaj shoqërive të tjera dhe këto kontrata risigurimi nuk e përjashtojnë shoqërinë nga detyrimi ndaj policëmbajtësve. Kështu që, ekziston një ekspozim kredie në lidhje me risigurimin e ceduar deri në masën që një risigurues nuk është në gjendje që të përmbushë detyrimet e tij sipas marrëveshjes risiguruese. Shoqëria nuk mban kolateral sipas marrëveshjeve risiguruese. Më 31 dhjetor 2024, shuma prej 16,696,725 Lekë (2023: 14,309,331 Lekë) paraqet pjesën e risiguruesit për detyrimet për primin e pafituar Jetë për Hua, Jetë dhe Shëndet në Udhëtim, Jetë dhe Aksidente në Grup dhe Jetë me Mbijetesë.

12. KOSTO TË SHTYRA TË MARRJES NË SIGURIM

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim sipas produkteve më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 janë si më poshtë:

	31.12.2024	Ndryshimi për periudhën	31.12.2023	Ndryshimi për periudhën
Jeta dhe shëndeti në udhëtim	242,744	(25,306)	268,050	13,929
Jeta dhe Sh.U. Studenti jashtë	1,683	1,683	-	-
Jeta dhe shëndeti (Cash Plan)	16,860,942	2,609,345	14,251,597	(6,373,389)
Jeta vizitori	2,935	1,159	1,776	(8,779)
	17,108,304	2,586,881	14,521,423	(6,368,239)

13. AKTIVE TË TJERA

Tt tjera llogari të arkëtueshme deri më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Shpenzime të parapaguara	992,558	1,218,399
Inventari i policave	2,005,866	1,823,644
Inventari i materialeve të tjera	233,380	299,129
Paradhënie e punonjësve	1,689,136	783,336
Të drejta për tu arkëtuar nga rimbursime	6,693,787	6,821,860
Debitorë të tjerë	5,537,062	1,691,417
Totali, bruto	17,151,789	12,637,785
Zhvlerësimi i debitorëve të tjerë	-	-
Totali, neto	17,151,789	12,637,785

14. INVESTIME NË PJESËMARRJE

Siç shpjegohet në shënimin nr. 1, Shoqëria SiCRED shiti aksionet e zotëruara në Credins Invest prej 12% gjatë vitit 2024. Investimi i Shoqërisë në Credins Invest për vitin 2023 paraqitet në pasqyrat financiare të konsoliduara dhe kontabilizohet duke përdorur metodën e kapitalit neto si më poshtë:

Credins Invest	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Aktive afatshkurtra	-	51,026,902
Aktive afatgjata	-	69,233,457
Detyrime afatshkurtra	-	(7,052,682)
Detyrime afatgjata	-	(7,048,207)
Kapitali	-	106,159,470
% e zotërimit	0%	12%
Vlera kontabël e investimit	-	12,739,136

Credins Invest	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Te ardhurat	-	70,240,127
Shpenzimet administrative	-	(55,355,741)
Shpenzimet financiare	-	980,888
Tatimi mbi te ardhurat	-	(2,530,071)
Kapitali	-	13,335,203
% e zotërimit	0%	12%
Të ardhurat/(humbjet) e periudhës nga investimi	-	1,600,224

Lëvizja në vlerën kontabël të investimit tregohet si më poshtë:

Credins Invest	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Investimi në fillim të periudhës	12,739,136	11,460,633
Te ardhurat nga shitja e investimit	2,186,931	-
Investimi në fund të periudhës	14,805,026	12,739,136
Ndryshimi	-	1,278,503
Të ardhurat/(humbjet) e periudhës nga investimi	-	1,600,224
Nga shpërndarja e dividendit	-	(321,721)

15. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Aktivët afatgjata materiale më datë 31 dhjetor 2024 janë paraqitur si më poshtë:

	Pajisje zyre informatike	Mobilie dhe pajisje	Automjete	Ndërtesa të përkohshme (Kiosk)	Vepra arti	Instalimet të përgjithshme	Rikonstrukcion i ambienteve me qira	Aktiv për të drejtën e përdorimit	Totali
Vlere Fillestare									
Gjendja me 31 dhjetor 2022	23,583,842	21,484,227	29,847,565	428,496	463,668	574,380	53,029,742	85,231,402	214,643,322
Shtesa	679,362	1,443,561	-	-	174,000	-	-	-	2,296,923
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-	(5,425,931)	(5,425,931)
Riklasifikime	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja me 31 dhjetor 2023	24,263,204	22,927,788	29,847,565	428,496	637,668	574,380	53,029,742	79,805,471	211,514,314
Shtesa	8,396,025	134,760	-	-	-	-	-	-	8,530,785
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-	(3,772,031)	(3,772,031)
Riklasifikime	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja me 31 dhjetor 2024	32,659,231	23,062,546	29,847,565	428,496	637,668	574,380	53,029,742	76,033,440	216,273,068
Amortizimi i akumuluar									
Gjendja me 31 dhjetor 2022	(17,908,992)	(17,003,010)	(13,496,903)	(197,491)	-	(520,746)	(39,847,746)	(40,479,916)	(129,454,804)
Ndryshimet e periudhës	(1,514,184)	(969,763)	(3,270,131)	(11,550)	-	(10,727)	(3,070,185)	(10,633,811)	(19,480,351)
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-	3,376,274	3,376,274
Riklasifikime	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja me 31 dhjetor 2023	(19,423,176)	(17,972,773)	(16,767,034)	(209,041)	-	(531,473)	(42,917,931)	(47,737,453)	(145,558,881)
Ndryshimet e periudhës	(3,015,816)	(1,004,915)	(1,308,052)	(10,972)	-	(8,580)	(3,074,155)	(9,873,706)	(18,296,196)
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-	2,977,375	2,977,375
Riklasifikime	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja me 31 dhjetor 2024	(22,438,996)	(18,977,683)	(18,075,088)	(220,013)	-	(540,053)	(45,992,085)	(54,633,785)	(160,877,704)
Vlera e mbetur									
Gjendja me 31 dhjetor 2022	5,674,850	4,481,217	16,350,662	231,005	463,668	53,634	13,181,996	44,751,486	85,188,518
Gjendja me 31 dhjetor 2023	4,840,028	4,955,015	13,080,531	219,455	637,668	42,907	10,111,811	32,068,018	65,955,433
Gjendja me 31 dhjetor 2024	10,220,236	4,084,864	11,772,476	208,483	637,668	34,327	7,037,657	21,399,655	55,395,365

Nuk ka asnjë peng apo garanci mbi aktivët afatgjata materiale të Shoqërisë.

15. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Aktiv për të drejtën e përdorimit

Duke filluar nga data 01 Janar 2019 Shoqëria aplikoi SNRF 16 për Qiratë duke njohur një aktiv me të drejtë përdorimi si dhe një detyrim për qiratë e klasifikuara më parë si qira e zakonshme për ambientet në përdorim. Matja fillestare është bërë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të cilat nuk janë paguar deri në këtë datë, duke përdorur një norme skontimi prej 5% për të gjitha kontratat e qirave. Gjatë vitit Shoqëria ka llogaritur dhe njohur në Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve vlerën e interesit të llogaritur dhe vlerën e amortizimit për Aktivin me të drejtë përdorimi. Gjithashtu, vlera e aktivit në përdorim dhe e detyrimit për qira është rregulluar për kontratat që kanë parashikuar modifikime në pagesat e detyrimeve.

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Aktive në përdorim (qira për ambiente)	76,033,440	79,805,471
Amortizim i akumuluar	(54,633,785)	(47,737,453)
	21,399,655	32,068,018

16. AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE

Aktivët afatgjata jomateriale përfshijnë programe kompjuterike të cilat janë detajuar si më poshtë:

	AQ të patrupëzuara në Proces	Totali
Kosto		
Gjendja më 31 dhjetor 2022	7,152,700	7,152,700
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023	7,152,700	7,152,700
Shtesa	-	-
Pakësime	(6,161,046)	(6,161,046)
Gjendja më 31 dhjetor 2024	991,654	991,654
Amortizimi i akumuluar		
Gjendja më 31 dhjetor 2022	-	-
Amortizimi i vitit	-	-
Riklasifikime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023	-	-
Amortizimi i vitit	-	-
Riklasifikime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	-	-
Vlera neto kontabël		
Gjendja më 31 dhjetor 2023	7,152,700	7,152,700
Gjendja më 31 dhjetor 2024	991,654	991,654

Shoqëria ka firmosur një marrëveshje për shërbime të integruara të software kompjuterike me “Infosoft SD” shpk. Përgjatë viteve 2019-2023, kontrata është rishikuar për ndryshime. Shuma prej 991,654 Lek (2023: 7,152,700 Lek) i përket aktiveve të patrupëzuara në proces në lidhje me këtë kontratë.

17. REZERVAT PËR PRIMET E PAFITUAR

Rezerva për primet e pafituar më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 përbëhet si më poshtë:

	31.12.2024	Ndryshimi për periudhën	31.12.2023	Ndryshimi për periudhën
Jeta për hua	73,065,250	1,452,739	71,612,511	1,059,777
Jeta & Aksidente në Grup	3,402,154	56,584	3,345,570	262,815
Jeta & Shëndet në Udhëtim	539,432	107,093	432,339	(108,343)
Jeta Nxënës & Studentë	46,699	44,291	2,408	(786,640)
Jeta & Shëndeti në Udhëtim - Studenti Jashtë	33,664	33,664	-	-
Jeta & Shëndeti ("Cash Plan")	43,233,185	(5,910,255)	49,143,440	(21,977,204)
Jeta me Mbijetesë ("Endowment")	9,244,546	1,302,713	7,941,833	968,290
Jeta vizitorit	22,573	9,901	12,672	(6,175)
Jeta me kursim	127,496	5,957	121,539	27,300
Jeta evolutive	654,955	498,927	156,028	143,234
	130,369,954	(2,398,386)	132,768,340	(20,416,946)

18. REZERVA PËR HUMBJEN DHE RREGULLIMI I SHPENZIMEVE TË HUMBJES

Rezerva teknike për dëmet më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Detyrimet bruto të sigurimit për humbjet dhe shpenzimin e rregullimit të humbjes	28,497,202	32,084,475
Detyrimet neto të sigurimit për humbjet dhe shpenzimin e rregullimit të humbjes 1 janar	28,497,202	32,084,475
Humbjet dhe shpenzimi i rregullimit të humbjes të paguara	(62,181,472)	(52,456,664)
Humbjet dhe shpenzimi i rregullimit të humbjes të ndodhura	69,761,478	48,869,391
Detyrimet neto të sigurimit për humbjet dhe shpenzimin e rregullimit të humbjes më 31 dhjetor	36,077,208	28,497,202
Detyrimet bruto të sigurimit për humbjet dhe shpenzimin e rregullimit të humbjes	36,077,208	28,497,202

Vonesa të konsiderueshme ndodhin në njoftimin e dëmeve dhe një masë e konsiderueshme e përvojës dhe gjykimit përfshihet në vlerësimin e detyrimeve të papaguara të sigurimit, kostot përfundimtare të të cilave nuk mund të vlerësohen me siguri në datën e raportimit. Detyrimet e sigurimit për humbjet dhe shpenzimin e rregullimit të humbjes përcaktohen mbi bazën e informacioneve në dispozicion, gjithsesi është e natyrshme në natyrën e biznesit të Shoqërisë që detyrimet përfundimtare mund të ndryshojnë si rezultat i zhvillimeve të mëvonshme. Më 31 dhjetor 2024 Shoqëria kishte 323 dëme të pazgjdhura (2023: 144) shumica e të cilave kanë të bëjnë me Sigurimin e Jetës Cash Plan, (313), të cilat kërkojnë më shumë kohë për investigim.

Dëme pezull	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Sigurimi i Jetës për Hua	1	3
Sigurimi i Jetës në Udhëtim dhe Shëndeti	8	2
Sigurimi i Jetës dhe Aksidentëve në Grup	-	-
Sigurimi i Jetës Cash Plan	313	138
Sigurimi i Jetës me Kursim	1	1
Total	323	144

18. Rezerva për humbjen dhe rregullimi i shpenzimeve të humbjes (vazhdim)

Rezerva për humbjen dhe rregullimi i shpenzimeve të humbjes sipas llojit të dëmit më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Provigjione për dëme pezull për Jetë për hua	14,226,970	14,664,677
Provigjione për dëme për Jete dhe shëndet në Udhëtim	1,822,293	753,019
Provigjione për dëme për Jetë dhe Aksidente në Grup		95,221
Provigjione për dëme për Cash Plan	19,951,261	12,918,700
Provigjione për dëme për Jetë me mbijetese	20,160	65,585
	36,077,207	28,497,202

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2022
Të raportuara por jo të paguara (RBNS)	21,122,879	14,664,677
Të ndodhura por jo të raportuara (IBNR)	13,734,326	13,737,304
Provigjione për trajtim dëmsh	1,220,002	95,221
	36,077,207	28,497,202

19. REZERVA MATEMATIKORE

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Sigurim jete me kursim	33,987,043	31,863,366
Sigurim jete me mbijetese	87,767,360	66,435,623
	121,754,403	98,298,989

20. LLOGARI TË PAGUESHME PËR SIGURIMET DHE RISIGURIMET

Detyrimet nga sigurimi dhe sigurimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Detyrime nga veprimtaria sigurimit	15,812,498	14,157,692
Detyrime nga veprimtaria risigurimit	2,459,985	6,234,380
	18,272,483	20,392,072

21. DETYRIME PËR QIRA PËR AKTIVET NË PËRDORIM

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Detyrime për qira (për ambiente)	31,430,628	46,746,434
Ndryshime në kontrata	(720,709)	(1,979,636)
Interesi i llogaritur	1,316,625	2,041,533
Pagesa e detyrimit	(10,248,091)	(11,947,985)
Efektet e kursit të këmbimit	(1,454,032)	(3,429,718)
	20,324,421	31,430,628

22. DETYRIME NDAJ INSTITUCIONEVE FINANCIARE

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Furnitorë për qira financiare	4,850,611	6,917,473
Llogari Bankare të zbuluara (Overdraft)	84,215	9,352
	4,934,826	6,926,825

Në vitin 2022, Shoqëria ka blerë autoveturë me qira financiare pranë Bankës Credins sipas Aktmarrëveshjes datë 01.07.2022, Nr.1486 me afat 60 muaj dhe me normë interesi 12M Euribor +4%, maksimumi 6%.

Teprica me datë 31 dhjetor 2024 prej 84,215 Lek (31 dhjetor 2023: 9,352 lek) përfaqëson tepricën e zbuluar të llogarisë së kartës së kreditit Mastercard Business referuar kontratës së overdraftit Nr.809/ Datë 18.03.2020 me afat 12 mujor, me limit 15,000 euro dhe me normë interesi mbi balancën debitorë të pjesës së përdorur Libor i Euros 12 mujore + 4.87 % me bazë vjetore.

23. DETYRIME TË TJERA

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 janë detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Furnitorë	10,332,750	6,737,674
Personeli, Sig. shoqërore, Tatimi mbi të ardhurat	2,156,084	2,503,461
Taksa të tjera të ndryshme nga tatimi	175,927	247,695
Parapagime nga individë në vlerësim rreziku	970,311	653,474
Dividendë të pagueshëm	15,960,370	-
Kreditorë të tjerë	3,063,283	2,620,879
Total	32,658,725	12,763,183

24. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali aksionar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2024 është 498,293,927 (2023: 498,293,927 Lekë) dhe përbëhet nga 498,294 aksione me vlerë nominale prej 1,000 Lekë për aksion dhe zotërohet nga aksionarët si vijon:

	31 dhjetor 2024		31 dhjetor 2023	
	në %	Vlera e aksioneve	në %	Vlera e aksioneve
Aleksandër Pilo	46.39%	231,152,000	46.39%	231,152,000
Renis Tërshana	30.16%	150,274,000	30.16%	150,274,000
Monika Milo	4.75%	23,664,000	4.75%	23,664,000
Maltin Korkuti	4.75%	23,664,000	4.75%	23,664,000
Kristino Kromidha	4.05%	20,199,000	4.05%	20,199,000
Egi Santo	2.37%	11,832,000	2.37%	11,832,000
Emi Santo	2.37%	11,832,000	2.37%	11,832,000
Arben Taipi	2.06%	10,271,000	2.06%	10,271,000
Petra Shomo	2.06%	10,271,000	2.06%	10,271,000
Artan Xhori	1.03%	5,134,927	1.03%	5,134,927
	100.00%	498,293,927	100.00%	498,293,927

24. Kapitali aksionar (vazhdim)

Me vendimin Nr. 06 datë 24.06.2020 Asambleja e Aksionarëve miratoi 11,797,234 lekë në shpërndarje dividendi.

Me vendimin Nr. 7 datë 25 qershor 2021 Asambleja e Aksionarëve miratoi rritjen e kapitalit nga fitimi i vitit 2020 për vlerën 3,675,905 lekë duke arritur në këtë mënyrë vlerën 493,737,905 lekë pa ndryshuar strukturën e kapitalit. Vendimi Nr. 7 datë 25 qershor 2021 me certifikimin e pasqyrave financiare nga audituesi i jashtëm edhe nën cilësinë e ekspertit kontabël të autorizuar, pas aprovimit nga AMF, është regjistruar sipas parashikimit të ligjit tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Me vendimin Nr. 5 datë 24 qershor 2022 Asambleja e Aksionarëve miratoi rritjen e kapitalit nga fitimi i vitit 2021 për vlerën 4,556,022 lekë duke arritur në këtë mënyrë vlerën 498,293,927 lekë pa ndryshuar strukturën e kapitalit. Vendimi Nr. 5 datë 24 qershor 2022 me certifikimin e pasqyrave financiare nga audituesi i jashtëm edhe nën cilësinë e ekspertit kontabël të autorizuar, pas aprovimit nga AMF, është regjistruar sipas parashikimit të ligjit tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit gjatë vitit 2023.

25. PRIME TË SHKRUARA BRUTO

Primi i shkruar bruto për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 është detajuar si më poshtë, bazuar në kategorinë e produktit:

	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2023
Prime nga Sigurim Jetë për hua	163,022,254	138,299,862
Prime nga Sigurim Jetë dhe shëndet (Cash plan)	33,232,101	65,732,710
Prime nga Sigurim Jetë dhe Aksidente në Grup	63,031,186	30,730,074
Prime nga Sigurim Jetë me Mbijetesë (endowment)	4,658,707	44,953,167
Prime nga Sigurim Jetë me kursim (Fondi)	48,141,459	10,753,916
Prime nga Sigurim Jetë dhe Shëndeti në Udhëtim	15,541,859	4,682,128
Prime nga Sigurimi Jetë me kursim	1,406,404	1,460,129
Prime nga Sigurim Jetë Vizitori	47,100	67,098
Prime nga Sigurim Jetë dhe Shëndeti në Udhëtim St.Jashtë	68,298	55,886
Prime nga Sigurim Jetë Nxënës dhe Studentë	67,300	13,200
Prime nga Sigurim Jete Evolutive	5,668,092	859,982
	334,884,760	297,608,152

26. PRIME TË ÇEDUARA NË RISIGURIM

	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2023
Për sigurimin Jetë për hua	22,286,750	19,081,170
Për sigurimin Jetë për Evolutive	108,326	28,603
	22,395,076	19,109,773

27. TË ARDHURA NGA INTERESI

Të ardhurat nga interesi janë si më poshtë:

	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2023
Të ardhura nga interesat e depozitave me afat	18,292,119	14,956,125
Të ardhura nga interesat e Obligacioneve	4,857,317	7,536,941
Të ardhura nga interesat e Bonove të Thesarit	1,890,265	2,625,982
Të ardhura nga interesat e llogarive rrjedhëse	1,350	25,832
Të ardhura nga kuotat e Fondit të investimit	-	169,247
	25,041,051	25,314,127

28. DËME TË PAGUARA TË SIGURIMIT

Dëme të paguara të sigurimit më 31 dhjetor 2024 janë në vlerën 69,761,478 Lek (31 dhjetor 2023: 48,869,391 Lek).

	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2023
Shpenzime për dëme	50,089,864	38,454,414
Sigurim jete me skemën e përfitimit	12,091,607	14,002,250
Rezerva teknike	7,580,006	[3,587,273]
	69,761,478	48,869,391

29. KOSTO TË MARRJES NË SIGURIM

Kostot e marrjes në sigurim janë detajuar si më poshtë:

	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2023
Komisione	72,408,161	56,396,293
Shpenzime publiciteti	15,840,502	20,171,512
Shpenzime ekzaminimi	17,621,358	16,922,174
Shpenzime për policat	240,208	262,540
	106,110,230	93,752,519

Kostot e marrjes në sigurim për çdo linjë produkti janë detajuar si më poshtë:

	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2023
Sigurimi i Jetës dhe shëndetit Cash Plan	25,680,826	20,307,551
Sigurim Jete për hua	54,807,906	49,706,479
Sigurim Jete dhe Shëndeti në Udhëtim	13,892,462	14,645,656
Sigurim Jete dhe Aksidente në Grup	7,057,024	5,290,624
Sigurim Jete Nxënës dhe Studente	2,093,959	2,914,919
Sigurimi i Jetës me elemente kursimi	75,532	860,411
Sigurimi i Jetës me Mbijetese	3,628	3,939
Sigurim Jete dhe Shëndeti në Udhëtim St.Jashte	13,448	12,250
Sigurim Jete të tjera	2,485,445	10,690
	106,110,230	93,752,519

30. SHPENZIME PERSONELI

	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2023
Paga	66,036,543	61,469,565
Shpërblim personeli	8,915,583	8,877,549
Kontribut i sigurimeve Shoqërore	4,391,904	3,298,646
Sigurim jete dhe kontribut pensioni	2,694,074	4,820,561
	82,038,104	78,466,321

31. SHPENZIMET ADMINISTRATIVE

Shpenzimet administrative janë detajuar si më poshtë:

	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2023
Komisione bankare	3,756,065	5,237,656
Shpenzime administrative të tjera	11,427,554	12,974,804
Shërbime të jashtme	8,111,185	2,897,076
Tarifa, tatime dhe gjoba	5,263,989	6,434,709
Publicitet, reklama	5,609,321	3,627,267
Ujë, energji dhe komunikim	3,615,993	3,478,194
Shpenzime për pritje dhe dhurata	2,357,919	3,360,739
Ruajtje objekti	1,737,252	1,737,252
Transferime, udhëtime, dieta	491,845	564,871
Shpenzime qiraje	57,000	59,166
	42,428,122	40,371,734

32. TË ARDHURA TË TJERA

Të ardhura të tjera janë detajuar si më poshtë:

	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2023
Të ardhura nga komisioni nga Risiguruesi	7,992,477	3,140,259
Të ardhura të tjera nga veprimtaria siguruese	463,296	257,620
Të ardhura të ndryshme	5,597,622	4,938,334
	14,053,396	8,336,213

33. SHPENZIMI AKTUAL I TATIMIT MBI FITIMIN

Më poshtë kemi paraqitur rakordimin e tatim fitimit të llogaritur me normën e aplikueshme të tatimit të fitimit:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Fitimi para tatimit	8,890,765	21,839,252
Shpenzime të pazbritshme për qëllime tatimore	11,408,604	14,705,201
Rregullimi në lidhje me investimin në filiale	696,633	1,034,640
Fatura të parregullta	260,592	365,847
Pritje- përcjellje	1,353,265	2,939,857
Zhvlerësime për borxhin e keq	411,500	4,804
Dieta jashtë limitit tatimor	56,222	92,115
Gjoba, penalitete, dëmshpërblime	111,400	2,056,768
Personeli shpenzime të pazbritshme	4,660,158	6,043,685
Shpenzime të tjera jashtë limitit	117,795	173,432
Amortizimi i aktiveve të rikonstruktura sipas SNRF	2,340,775	2,287,366
Shpenzimi i njohur sipas tatimeve me 5%	-	-
(I zbritshëm)/I pazbritshëm nga detyrimi tatimor i shtyrë	942,242	(293,313)
Humbja nga shitja/dëmtime e Aktiveve	458,023	-
Rezultati tatimor	20,299,369	36,544,453
Të ardhura të patatueshme	-	-
Fitimi i taksueshëm për vitin	20,299,369	36,544,453
Shpenzimi i tatim fitimit	3,044,905	5,481,668
Shpenzimi/(përfitimit) nga detyrimi tatimor i shtyre	-	43,996
Shpenzimi i tatim fitimit për vitin aktual 15%	3,044,905	5,525,664

Tatimi fitimi në Shqipëri në vitin 2024 llogaritet duke aplikuar normën 15% (2023: 15%) mbi fitimin para tatimit. Shpenzimet e pazbritshme janë të gjitha shpenzimet të pa shoqëruara me dokumentacion, siç kërkohet nga ligji Shqiptar, të gjitha shpenzimet që janë të shoqëruara me dokumenta por që nuk janë të njohura nga autoritetet tatimore dhe gjoba të marra për vonesat në dokumentacion drejt Drejtorisë së Tatimeve. Këto shpenzime regjistrohen si të tilla por nuk janë të zbritshme për qëllime tatim fitimi.

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Fitimi para tatimit	8,890,765	21,839,252
Shpenzime të pazbritshme për qëllime tatimore	11,408,604	14,998,514
Rregullimi në lidhje me investimin në filiale	696,633	1,034,640
Fatura të parregullta	260,592	365,847
Pritje- përcjellje	1,353,265	2,939,857
Zhvlerësime për borxhin e keq	411,500	4,804
Dieta jashtë limitit tatimor	56,222	92,115
Gjoba, penalitete, dëmshpërblime	111,400	2,056,768
Personeli shpenzime të pazbritshme	4,660,158	6,043,685
Shpenzime të tjera jashtë limitit	117,795	173,432
Amortizimi i aktiveve të rikonstruktura sipas SNRF	2,340,775	2,287,366
Shpenzimi i amortizimit dhe interesave sipas SNRF 16	11,190,333	-
Shpenzimi i qerave (operacionale)	(10,248,091)	-
Diference për sigurimin e jetës së stafit	458,022	-
Rezultati tatimor	20,299,369	36,837,766
Të ardhura të patatueshme	-	-
Fitimi i taksueshëm për vitin	20,299,369	36,837,766
Shpenzimi i tatim fitimit	3,044,905	5,525,664

33. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin (vazhdim)

Analiza e llogarisë “Detyrimi për tatim fitimin” për vitin 2024 dhe 2023 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Të pagueshme më 1 janar	(3,424,900)	(361,219)
Pagesa deri më 31 dhjetor	8,371,680	2,461,983
Shpenzimi i tatimit për vitin	(3,044,905)	(5,525,664)
Të pagueshme më 31 dhjetor	1,901,874	(3,424,900)

34. DETYRIMI TATIMOR I SHTYRË

Analiza e llogarisë “Detyrimi tatimor i shtyrë” për vitin 2024 dhe 2023 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Shpenzimi i amortizimit dhe interesave sipas SNRF 16	11,190,333	12,618,671
Shpenzimi i qirasë (operacionale)	(10,248,091)	11,947,985
Diference tatimore e perhershme (fshirja e detyrimit tatimor të shtyrë në vitin 2024, dhe njohja si shpenzim i pazbritshëm)	(942,242)	-
Diferenca	-	670,686
% e tatimit	15%	15%
Detyrim tatimor i shtyrë	-	100,603

Ndryshimi në aktivin tatimor të shtyrë më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Detyrim tatimor i shtyrë më 1 janar	100,603	144,599
Ndryshimi i periudhës	(100,603)	(43,996)
Detyrim tatimor i shtyrë më 31 dhjetor	-	100,603

35. VEPRIMET ME PALËT E LIDHURA

Palët konsiderohen të jenë të lidhura nëse një palë ka mundësinë që të kontrollojë ose që të ketë influencë të rëndësishme mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operacionale, ose palët janë nën kontroll të përbashkët me Shoqërinë. Shoqëria ka një marrëdhënie si palë e lidhur me aksionarët e saj dhe me shoqëritë:

- CREDINS INVEST sha
- SiCRED Assistance
- SiCRED Distribution

Një njësi ekonomike që përdor një kompani menaxhimi (një njësi ekonomike që ofron shërbime të rëndësishme të menaxhimit të personelit) është e nevojshme që të paraqesë shpenzimet e bëra për shërbimet e menaxhimit. Shoqëria nuk ka marrë ndonjë shërbim të menaxhimit nga subjektet e tjera.

Një numër transaksionesh janë kryer me palët e lidhura në aktivitetin normal të biznesit. Këto transaksione janë kryer me terma tregtare dhe në kushte tregu.

35. Veprimet me palët e lidhura (vazhdim)

Volumi i këtyre transaksioneve dhe balancat në fund të periudhave respektive janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Të arkëtueshme	6,540,064	4,362,018
SiCRED Assistance		-
SiCRED Distribution	6,540,064	4,362,018
Primet e shkruara bruto	3,405,905	3,015,808
Sigurimi i Jetës	3,405,905	3,015,808
Shpenzimet e sigurimit	2,371,398	880,133
Dëme të paguara	2,371,398	880,133
Dividenti i paguar	17,348,229	7,250,215
Dividenti i paguar aksionareve	17,348,229	7,250,215
Të ardhura të tjera	302,119	1,241,043
Nga dividendi dhe shërbime të tjera	302,119	1,241,043
Të pagueshme për kontribut Vullnetar	4,436,120	1,760,234
Nga Punëdhënësi	1,979,360	881,746
Nga Punëmarrësi	2,456,760	878,488
Shpenzimet administrative	5,535,086	5,285,952
Shërbime nga SiCRED Assistance	462,000	462,000
Shpenzime për ambiente me qira	2,589,040	2,789,092
Blerje nga SiCRED Distribution	2,178,046	1,728,860
Pagesa për Keshillin Mbikqyres	306,000	306,000

Kompensimi total për drejtuesit kryesorë të Shoqërisë, të përfshira në shpenzimet administrative si shpenzime page për fundin e vitit 31 dhjetor 2024 është 8,125,000 Lek (2023: 8,450,000 Lek).

36. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË MUNDSHME

Çështje gjyqësore

Në veprimtarinë e zakonshme të biznesit, Shoqëria përfshihet në çështje të ndryshme gjyqësore. Sipas opinionit të drejtimit dhe avokatit ligjor, shoqëria nuk ka dëme që kërkojnë shënime shpjeguese apo njohje të provizioneve në përputhje me SNRF-të. Shoqëria nuk ka angazhime të rëndësishme në datën e raportimit.

37. NGJARJE PAS DATËS SË PASQYRAVE FINANCIARE

Nuk ka ngjarje pas datës së raportimit që mund të kërkojë rregullim apo pasqyrim të informacionit në pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë.

RRJETI I DEGËVE

Zyrat Qendrore SiCRED

Adresa: Njësia Bashkiake Nr.5,
Rr. "Brigada VIII", Vila Nr. 3/1, Tiranë
Tel: +355 4 22 37 549
Cel: + 355 69 20 84 026
Fax: +355 4 22 37 530
e-mail: contact@sicred.com.al
web: www.sicred.com.al

Dega Tiranë

Adresa: Njësia Bashkiake Nr.5,
Rr. "Brigada VIII", Vila Nr. 3/1, Tiranë
Tel: +355 4 22 37 549
Cel: + 355 69 20 84 026
Fax: +355 4 22 37 530
e-mail: shitje@sicred.com.al

Dega Durrës

Adresa: Lagjja Nr.3, Rr. "Rruga
Tregtare", (Blv. "Epidam"), Durrës
Tel/Fax: +355 52 90 66 35
Cel: +355 69 60 65 916
e-mail: dures@sicred.com.al



